



Konrad  
Adenauer  
Stiftung



Institute for Democracy  
Societas Civilis - Skopje

# DIALOGU POLITIK

Dr. Nenad Marković  
Misha Popović





# DIALOGU POLITIK

---

Dr. Nenad Marković

Misha Popović

## Autorësia

### Titulli:

Dialogu politik

### Botues:

Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, në bashkpunim me Institutin për demokraci "Societas Civilis"-Shkup

### Autor:

Nenad Markovikj  
Misha Popovikj

**Përkthimi:** Vlora Reçica

**Dizajn dhe përgaditje:** Vladimir Barlakoski

**Publikimi mundet pa pagesë të shkarkohet nga:**

<http://www.kas.de/macedonien>

<http://www.idscs.org.mk>

### Vërejtje:

**Qëndrimet e paraqitura në këtë publikimi nuk janë qëndrime të Fondacionit Konrad Adenauer dhe të Institutit për demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) por pikpamje personale të autorëve.**

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

323(497.7)"1991/..."

328(497.7)"1991/..."

329(497.7)"1991/..."

МАРКОВИЌ, Ненад

Политички дијалог / Ненад Марковиќ, Миша Поповиќ. - Скопје :  
Фондација Конрад Аденауер, 2015. - 68 стр. : граф. прикази ; 18 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 64-66

ISBN 978-608-4648-17-8

1. Поповиќ, Миша [автор]

а) Политички системи - Партии - Македонија - 1991-... б) Македонија

- Внатрешна политика - 1991-...

COBISS.MK-ID 99089162

## Përmbanë:

Lista e shkurtesave të përdorura në manual	7
Përkufizimi i dialogut politik	9
Ndërtimi i besimit	11
Konkurrenca dhe bashkëpunimi	13
Dinamika i dialogut politik	14
Histori e shkurtër e krizave në dialogun politik	17
Qeveria teknike, qeveria e parë politike në RM dhe bojkoti i parë i Parlamentit	20
Kriza e vitit 2001	21
Ligji për organizim territorial të 2004	24
Marrëveshja e Maj të vitit 2007	25
Kriza parlamentare në dhjetor 2012	28
Lëshimi i Kuvendit nga LSDM-ja dhe PDSH-ja në vitin 2014	29
Kultura e dialogut në RM	30
Aktorët kryesorë	35
1. VMRO-DPMNE	37
2. LSDM	37
3. BDI	38
4. PDSH	38
5. Partitë më të vogla	39
Hapësira formale për dialog politik	39

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë	40
Qeveria e Republikës së Maqedonisë	44
Presidenti i Republikës	46
Hapësira joformale për dialog politik	48
Shoqëria Civile	49
Media	52
Bashkësitë fetare	54
Bashkësia ndërkombëtare	55
Studimi i rastit “Wilton Park”	55
Kriza Parlamentare e 24 dhjetorit 2012	58
Përfundimi	63
Bibliografia	64

## **Lista e shkurtesave të përdorura në manual**

IREX - International Research and Exchange Board

VMRO-e vërteta - Opcioni Reformues i vërtetë Maqedonas

VMRO-DPMNE - Organizata e Brendshme Revolucionare  
Maqedonase - Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas

GROM - Opcioni Qytetar për Maqedoninë

DOM – Ripërtëritja Demokratike e Maqedonisë

PD - Partia Demokratike

PDSH - Partia Demokratike Shqiptare

BDI - Bashkimi Demokratik për Integrim

BE - Bashkimi Evropian

IDSCS - Instituti për Demokraci “Societas Civilis” - Shkup

PLD - Partia Liberale Demokratike

PL - Partia Liberale

PLM - Partia Liberale e Maqedonisë

NATO / NATO - Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior

RDK – Rilindja Demokratike Kombëtare

NSDP - Partia e Re SocialDemokrate

UÇK - Ushtria Çlirimtare Kombëtare

MKO - Marrëveshja Kornizë e Ohrit

PPD - Partia për Prosperitet Demokratik

RM-Republika e Maqedonisë

SHBA - Shtetet e Bashkuara

LSDM - Lidhja Social-Demokratike e Maqedonisë

KBM - Kongresi Botëror Maqedonas

PS - Partia Socialiste



## PËRKUFIZIMI I DIALOGUT POLITIK

Si shumë fenomene sociale dhe dialogun politik mund të kuptohet ngushtë dhe gjerë. Nëse ne flasim për kuptimin më të gjerë, dialogu politik është një proces në të cilin ndryshimet shoqërore të kryera nga proceset politike shkojnë nëpërmjet një procesi relativisht të hapur të dialogut dhe debatit në të cilin mund të marrin pjesë aktorë të ndryshëm. E parë ngushtë, dialogu politik mund të kuptohet si një proces të dialogut mes partive politike, si aktorët kryesorë në luftën politike brenda procesit vendim-marrës.

Sigurisht, ajo është dialogu në këtë kuptim të kontekstualizohet përmes prizmit të një vendimi të përbashkët ose të reflektimit. Shqyrtimi/deliberimi është një proces përmes të cilit pjesëmarrësit kalojnë përmes “shkëmbimit të vërtetë të argumenteve.”<sup>1</sup> Përveç kësaj, është i duhur një sistem në të cilin reagohet drejt argumenteve të parashtruara dhe gatishmëri për të ndryshuar mendim.<sup>2</sup>

Palët duhet të kenë si parakusht të kenë mbajtjen e suksesshme dhe afatgjate të dialogut ndër-partiak, kapacitete për demokraci të brendshme dhe aftësinë përmes analizave dhe hulumtimit të formulojnë program.<sup>3</sup> Kështu, pjesëmarrja e tyre në dialog do të bazohet në parime afat-gjate dhe pozitive përmes të cilave gjatë dialogut, do të marrin pjesë në proces. Përndryshe, në qoftë se demokracia e brendshme mungon, drejtimit e veprimtarisë së partisë do të jetë vetëm në funksion të drejtimit që merr udhëheqja e tanishme ose oportunitizmi.

1 Rasch, Erik Bjorn. Legislative debates and democratic deliberation in parliamentary systems. Preliminary draft paper for Presentation at the Oslo-Yale International Workshop on Epistemic Democracy in Practice, Yale University, New Haven, 20-22 October, 2011. Në dispozicion në <http://goo.gl/TbgYhs> (qasur më 14.07.2014)

2 Ibid и повеќе во Mercier and Landmore (2010)

3 Kemp, B., 2013. Political Party Dialogue: A Facilitator's Guide. International IDEA / NIMD / The Oslo Center. стр. 30

Dialogu politik ndërmjet palëve më shpesh ndodh në “hapësirë” në të cilën do të përballen pikëpamjet kontradiktore të aktorëve.<sup>4</sup> Si hapësirë politike zakonisht nënkuptohen trupat parlamentare, ku përfaqësuesit e zgjedhur të partive të ndryshme politike marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes, duke përfaqësuar interesa të ndryshëm. Në Kuvend, si “hapësirë”, vendi i dialogut politik përveç në plenum ka edhe në komisione të ndryshme të përhershme ose të përkohshme. Megjithatë, në varësi të sistemit politik, ka grupe jashtëpratiqë të zyrtarëve me pikëpamje të ngjashme politike, interesa apo përfaqësimeve.<sup>5</sup>

Parlamenti si hapësirë nuk është patjetër i lidhur me dialogun politik. Së pari, debati parlamentar jo gjithmonë përfshin dialogun dhe shpesh është kornizë në të cilën realizohet pëleshje ndërmjet pozicioneve të ndryshme në mënyrë që të fitojnë vota.<sup>6</sup> Kjo theksohet edhe nga vendosja (set-up) teknike në kuvend si një hapësirë (potenciale) për dialog, ku koha për të diskutuar dhe e kufizuar. Ky kufizim, largon diskutimin nga mundësia që të jetë në gjendje të jetë debat sepse nuk lë hapësirë për shkëmbim më të gjatë që është e nevojshme në procesin e dialogut.<sup>7</sup>

Së dyti, potenciali për të nisur dialog politik në mënyrë të konsiderueshme varet nga marrëdhëniet e pushtetit mes partive përfaqësuesit e përbëjnë parlamentin. Në rastet në të cilat me shumicën parlamentare dominon një parti ose koalicion i qëndrueshëm procesi shpesh mund të çojë deri tek injorimi i opozitës. Në anën tjetër, në kushte të balancuara, procesi i vendimmarrjes në Kuvend mund të jetë më i favorshëm për inicim të dialogut, sepse bashkëpunimi është i nevojshëm për të qenë në gjendje të marrë vendime dhe ligje.<sup>8</sup>

Përveç kësaj, lidhja ndërmjet vendimeve të partive dhe përfaqësuesve të partive në parlament nuk është gjithmonë e fortë. Ka skenarë të ndryshme në varësi të sistemit zgjedhor dhe politik të vendit. Shpesh here vendimet

---

4 Ibid fq. 24

5 Ibid fq. 24

6 Ibid fq. 29

7 Rasch 2011

8 Kemp 2013 fq. 29

e partisë i sjell elita partiake në të cilat deputetët mund të jetë pjesë.<sup>9</sup> Kështu, bashkëpunimi (ose dëshira për bashkëpunim) në Parlament nuk do të prodhojë një hapësirë për dialog ndër-partiak, sepse vendimet për qëndrimet e partive, ose për rezultatin e vendimmarrjes mirren diku tjetër.

Megjithatë, hapësira për dialog ndër-partiak nuk është i lidhur domosdoshmërisht me trupin ligjvënës (psh. Kuvendi) dhe ai, në varësi të kontekstit politik mund të gjendet jashtë trupave të zakonshëm. Forma të tilla të dialogut ndër-partiak mund të organizohen për të kapërcyer krizën politike; për të bërë hapësirë për përfshirjen e më shumë aktorëve partiak ose jasht-partiak; ose me qëllim për ndërtimin e një konsensusi më të gjerë në procesin reformues. Shpesh vendi i kësaj hapësire është jashtë organeve institucionale, por në të njëjtën kohë, procesi i dialogut është domosdoshmërisht i strukturuar për të inkurajuar bashkëpunimin.

Një mënyrë e dobishme për të marrë përshtypjen e nivelit të thellësis që dialogu politik mund të marrë, është që proceset e dialogut të ndahen sipas mënyrës së komunikimit.

Sipas ndarjes të Jay Rothman, lloji i parë i dialogut është dialogu i marrëdhënieve njerëzore. Në këto raste, dallimet esenciale nuk janë subjekt i punës dhe fokusi është në keqkuptime dhe steroetipite.<sup>10</sup>Lloji i dytë është dialogu aktiv ku qëllimi është të identifikohen qëndrimet e përbashkëta për organizimin e veprimeve të përbashkëta.<sup>11</sup> Lloji i tretë i dialogut, ku në kuptimin më të thellë e shfrytëzohet potenciali i procesit, është dialog për të zgjidhur probleme. Në këtë lloj, veprim i përbashkët është i organizuar rreth çështjes ku ka dallime.<sup>12</sup>

## NDËRTIMI I BESIMIT

Baza për një dialog të qëndrueshëm është të ket besim minimal ndërmjet

9 Ibid fq. 29

10 Ropers, N., 2004. From Resolution to Transformation: The Role of Dialogue Projects, in: Berghof Handbook for Conflict Transformation. Berghof Foundation, Berlin.crp 3

11 Ibid fq. 3

12 Rothman, Jay 1998. „Dialogue in Conflict: Past and Future,“ во Ropers 2004 cрp 3

kundërshtarëve politikë të cilët janë të përfshirë në këtë proces.<sup>13</sup> Përveç kësaj, faktorë rëndësues janë mungesa e vullnetit politik dhe një çekuilibër i rëndësishëm i pushtetit.<sup>14</sup> Nëse palët janë parë vetëm si armiq nuk ka bazë mbi të cilën mund të ndërtohet dialog, sepse aktorët vazhdimisht do të shikojnë qëllime të fshehura pas aktiviteteve të tjetrit.<sup>15</sup>

Ky besim minimal dmth gatishmëri të ulen së bashku dhe të kuptojn se ana tjetër sinqerisht afrohet drejt dialogut. Në kushte në të cilat atmosfera është e polarizuar dhe e tensionuar kjo është më e vështirë të arrihet. Prandaj, dialogu politik ndër-partiak duhet të fillohet ngadalë, me aktivitete që lidhen me hartimin e procesit të dialogut dhe kuptimin i të mirave nëse përfshihen, si dhe aktivitete për të zvogluar tensionet personale midis politikanëve që marrin pjesë në proces.<sup>16</sup>

Dialogu përdoret kryesisht si teknikë për të zgjidhur konfliktet për “transformim psikosocial”.<sup>17</sup> Kjo është për shkak se metodologjikisht, puna e dialogut është të përqëndruarit në komunikim dhe marrëdhëniet ndërpersonale.<sup>18</sup>

Përveç kësaj, në kushte kur dialogu i tillë është me ndërmjetësues, krijohet problem me ndërtimin e besimit drejt ndërmjetësuesit. Tipar kryesor i ndërmjetësuesit të suksesshëm është paanshmëria, që do të thotë se pavarësisht nga pikëpamjet personale dhe pozicionet, ndërmejtësuesi/ sja qaset hapur dhe i ekuilibruar drejt pikëpamjeve dhe pozicioneve të aktorëve.<sup>19</sup>

Një faktor i rëndësishëm për jetëgjatësinë e përfitimeve të dialogut politik është sigurimi i pronësinë (ownership) nga partitë për vet procesin dhe produktin e këtij procesi.<sup>20</sup> Kjo do të thotë se nëse dialogu ndër-partiak

---

13 United Nations Development Programme, 2009. Why dialogue matters for conflict prevention and peacebuilding. fq. 3 në dispozicion në <http://goo.gl/JvoMiG> (Пристапено 14.7.2014)

14 Ibid

15 Kemp 2013 fq. 89

16 Ibid fq. 92

17 Ropers 2004 fq. 1

18 Ibid fq. 1

19 Kemp 2013

20 UNDP fq. 5

është kryer me apo pa ndërmjetës pjesëmarrësit duhet të shohin procesin si të vetin dhe jo si një produkt i presionit të jashtëm.<sup>21</sup> Bazë për këtë është perceptimi që pjesëmarrësit e udhëheqin procesin dhe vendosin në cilin drejtim do të lëviz.<sup>22</sup>

Në të njëjtën mënyrë, presionet e jashtme dhe vendosja e axhendës të para-përcaktuar mund të jenë të dobishme kryesisht si drejtim ose temë e platformës për dialog. Ato janë më pak të dobishme për dialogun në qoftë se kanë për qëllim të determinojnë që më parë rezultatin dhe produktin e dialogut politik.<sup>23</sup>

## KONKURRENCA DHE BASHKËPUNIMI

Baza e jetës politike të partive është konkurrenca për “pushtet dhe ndikim.”<sup>24</sup> Megjithatë, procesi politik nuk mund të bazohet vetëm në konkurrencën ndër-partiake sepse ajo nuk krijon kushtet në të cilat partitë do të bashkëpunonin me njëra-tjetrën. Në këtë kuptim, bashkëpunimi mund të shihet si një faktor kyç për “reforma demokratike ... (dhe) konsolidimit” afat-gjatë.<sup>25</sup>

Ka disa forma të bashkëpunimit:<sup>26</sup>

- Një koalicion i madh - gjendje në të cilën partitë e shumta formojn koalicion në trupin lighvënës për sjelljen e legjislacionit apo për të formuar qeverin;
- Komisionet parlamentare - ku përfaqësues të partive të ndryshme përfshihen në diskutimin e propozimeve dhe formulimin e rekomandimeve;

21 Ibid

22 Kemp 2013 fq. 34

23 Ibid fq. 35

24 Ibid fq. 25

25 Ibid fq. 25

26 Ibid fq. 25

- Grupet tematike jasht-partiake (caucus) - Grupe joformale të përfaqësuesve nga parti të ndryshme që kanë pozicione të ngjashme;
- Dialogu ndër-partiak i institucionalizuar - i cili përfshin përfaqësues nga parti të ndryshme, shpesh në formën e një platforme për diskutim;
- Dialogu joformal politik – gjendje në të cilën, cilët do qoftë përfaqësues të partive të ndryshme hyjnë në proces bashkëpunimi.

Varësisht nga shkalla e bashkëpunimit dhe nevojës për dialog, skenarët në vijim janë të mundshëm:<sup>27</sup>

1. Të gjitha palët janë të hapur për dialog, pa ndërmjetësi;
2. Të gjitha palët janë të hapur për dialog, por është i nevojshëm ndërmjetës;
3. Disa parti janë të hapur për dialog - të tjerët janë kundër;
4. Asnjë parti nuk është e hapur për dialog

Në disa nga këto skenarë parashihet funksioni i ndërmjetësuesit si një pikë e cila do të organizojë dinamikën e dialogut ndër-partiak. Në varësi të skenarit, niveli i proaktiviteti të ndërmjetësuesit oscilon , për aq kohë sa skenari (2) ai / ajo ka një rol më teknik, në skenarin (3) dhe (4) është i duhur dinamik më e madhe me qëllim të inicimit të dialogut.<sup>28</sup>

## **DINAMIKA I DIALOGUT POLITIK**

Dialogu politik ndër-partiak mund të merr forma të ndryshme në varësi të konteksteve politike në të cilat ai zhvillohet. Në mënyrë të ngjashme struktura dhe fazat e dialogut mund të kenë forma të ndryshme dhe të jenë të përshtatura me specifikat e pyetjes rreth cilës zhvillohet procesi,

27 Ibid fq. 31

28 Ibid fq.31

dinamikës së pushtetit, por edhe nivelit të besimit mes aktorëve të përfshirë në këtë proces.

Megjithatë, mund të përshkruhet korniz e përgjithshme e fazave të dialogut politik. Kjo pjesë e manualit është e shkurtuar dhe version parafrazuar i frymëzuar nga “Dialogu i partive politike: manual për lehtësuesit”, nga Brektje Kemp - manual i cili tërheq nga përvoja praktike e dialogut politik nëpër vende të shumta në botë.<sup>29</sup>

Faza e parë paraqet shqyrtim të mundësive për dialog. Në këtë fazë përgatet analizë e situatës, kontekstit dhe aktorëve. Njëkohësisht, kjo faze analizohet se sa do të jetë vlera e shtuar e dialogut drejt zgjidhjes së situatës së dhënë si dhe mundësitë që janë në dispozicion që të iniciohet fillimi i një procesi të bashkëpunimit.

Faza e dytë paraqet dizajnimin e dialogut politik. Tek kjo fazë konceptohet struktura dhe procedurat e dialogut si dhe “rregullat e lojës”. Faza e tretë është zakonisht shënon fillimin e dialogut. Varësisht nga rasti, kjo fazë mund të jetë eksplicite dhe e shënuar me nënshkrimin e marrëveshjes apo memorandumit me çka dialogu është i promovuar para votuesve, mediatve por edhe para aktorëve të tjerë shoqëror të cilët kanë interes për këtë temë.

Faza e katërt e procesit të dialogut, e cila paraqet thelbin e dialogut ndër-partiak, është implementimi. Në këtë fazë aktorët në dialog marrin pjesë në procesin e shkëmbimit të pikëpamjeve dhe marrëveshjeve. Megjithatë, dialogu nuk është një proces i izoluar dhe nuk varet vetëm nga pjesëmarrësit, por edhe nga partitë që këta pjesëmarrës përfaqësojnë. Prandaj, ky proces duhet të përfshijë edhe procese të harmonizimit brenda partisë. Kjo shton një komponent kohor në proces, prandaj dialogu i dizajnuar me sukses duhet të lë hapësirë për dinamik brenda partisë.

Faza e fundit paraqet mbyllje të dialogut ndër-partiak. Kjo fazë është karakteristike e dialogut ndër-partiak i krijuar për të zgjidhur një çështje të caktuar, dhe jo për procese afat-gjate forumi ndërmjet partive. Përmbyllja e dialogut bëhet edhe në rastet kur procesi është i pasuksesshëm, por janë

---

29 Kemp, B., 2013. Political Party Dialogue: A Facilitator's Guide. International IDEA / NIMD / The Oslo Center.

shteruar mundësitë për marrëveshje dhe bashkëpunim.

Një faktor i rëndësishëm në dinamikën e dialogut politik ndër-partiake është cikli elektoral. Partitë në mënyrë të pashmangshme funksionojnë brenda këtij cikli i cili përcakton marrëdhëniet e tyre gjatë kalimit të kohës. Fazat e ndryshme të këtij cikli sigurojnë, më shumë ose më pak mundësi për zhvillimin e dialogut ndër-partiak.

Në fazën parazgjedhore, edhe pse partitë i transformojnë marrëdhëniet e tyre në garuese, dialogu ndër-partiak mund të përfitojë nëpërmjet ndërtimit të besimit në mes të kundërshtarëve dhe zhvillimit të diskutimit rreth zgjedhjeve dhe regullatives. Dialogu për çështjet kundërthënëse apo reforma në këtë periudhë është më i vështirë.


Në kuadër të fazës zgjedhore, dialogu ndër-partiak ka rritëm të ngadalshëm, dhe çështjet që përfitojnë nga dialogu në këtë periudhë janë kryesisht të lidhura me procesin zgjedhor. Një shembull i kësaj janë kodekset e sjelljes të cilat partitë i miratojnë dhe / ose nënshkruajnë në këtë periudhë.

Dialogu politik në fazën post-zgjedhore ka një ritëm të ngadalshëm. Ndërmjetësuesit zakonisht e përdorin këtë kohë për analiza të kontekstit dhe aktorëve të ri. Intensifikimi i dialogut në këtë periudhë mund të jetë për shkak të nevojës për pajtim, shpesh në rastet kur fushata ka qenë e ashpër dhe ka akuza për abuzimin zgjedhor.

Dialogu ndër-partiak ka potencialin më të madh në fazën e konsolidimit, e cila zgjat midis heshtjes së euforisë post zgjedhore dhe fillimit të aktiviteteve të reja të fushatës së ardhshme. Në këtë fazë mundësitë për dialog mbi çështjet e mëdha janë më të mëdha për shkak se presioni i konkurrencës është më i ultët. Megjithatë, kjo fazë nuk zgjat njësoj dhe shpesh varet nga shkalla e stabilitetit të sistemit politik. Demokracitë e qëndrueshme më para hyjnë në fazën e konsolidimit, e lë më shumë kohë për dialog substancial politik.



Diagram: Cikli i zgjedhjeve dhe llojet më të zakonshme të dialogut në fazat e ndryshme



Së fundi, duhet shtuar se dialogu politik është vetëm pjesë e procesit të transformimit të konflikteve. Për të zgjidhur konfliktet afat-gjata, është e nevojshme paralelisht me dialogun të zhvillohen edhe ndryshime që do të eliminojnë burimet strukturore të konfliktit.<sup>30</sup>

## HISTORI E SHKURTËR E KRIZAVE NË DIALOGUN POLITIK

Fusha politike në Maqedoni pas pavarësisë deri më sot, ka kaluar nëpër një numër të krizave në dialogun politik. Disa prej këtyre krizave kanë pasur për burim oscilimet e marrëdhënieve ndëretnike në vend, disa ishin rezultat i ngadalësimit të dialogut politik midis qeverisë - opozitë, dhe disa janë për shkak të paqartësive kushtetuese dhe ligjore të pranishme në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë. Në këtë udhëzues, ne do të përqipemi për të

30 Ropers 2004 fq.1

bërë një pasqyrë të krizave më të rëndësishme dhe më të mëdha politike në Maqedoni dmth ato kriza që kanë lënë shenjë në peisazhin politik të vendit. Kjo sigurisht nuk paraqet listen e plotë të krizave në dialogun politik në vend, por vetëm përpjekje për të dhënë një kronologji të krizave politike që shpesh kanë origjinën pikërisht në defektet dhe mangësitë e dialogut politik në Maqedoni.

Si do të tregojë historiati i krizave politike në Maqedoni, duket se për të kapërcyer krizat në dialogun politik në vend është shpesh për shkak të përfshirjes së një pale të tretë (zakonisht të bashkësisë ndërkombëtare), dmth, sistemi politik tregon kapacitet të kufizuar për t'u marrë me krizat e brendshme politike. Kjo është përsëritur në shumë raste dhe alternative është që krizat politike të mbeten të pa zgjidhura, dmth të jenë pjesë integrale e funksionimit të sistemit politik. Historia e krizave politike në Maqedoni tregon se krizat politike shpesh tejkalohen jasht institucioneve të sistemit, dmth mbi të gjitha jasht Parlamentit, ndërsa modaliteti që përdoret zakonisht janë e mbledhjet liderëve. Kjo gjithashtu tregon për zgjidhjet jasht-institucionale të krizave politike, e cila nga përjashtim kthehet në rregull në rastin e krizave në dialogun politik në Maqedoni.

Tabela e krizave të mëdha në dialogun politik në Maqedoni

Kriza	Burimi i krizës	Aktorët kryesor	Mënyra e tejkalimit
Bojkotimi i Parlamentit nga deputetët e VMRO-DPMNE dhe Partisë Demokratike (rrethi i dytë - Zgjedhjet 1994)	Parregullsitë zgjedhore	Partitë aktive politike në zgjedhjet në 1994 (LSDM, PLM, PS, VMRO-DPMNE dhe PD)	Kriza nuk u tejkalua – Kuvendi gjatë tërë mandatit punoi pa përfaqësues të VMRO-DPMNE-së dhe PD
Kriza në vitin 2001	Tensione ndëretnike dhe konflikt, përhapje e krizës së Kosovës në vitin 1999 në Maqedon	Qeveria e Maqedonisë, strukturat rebele, partitë politike në Maqedoni (LSDM, VMRO-DPMNE, PPD, PDSH)	Presion politik nga BE dhe SHBA - negociata politike dhe miratimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit
Ligji për organizim territorial e vitit 2004 (referendum)	Paqartësia e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit	Qeveria e RM-së, opozita politike (VMRO-DPMNE), Kongresi Botëror Maqedonas	Kriza përfundoi me pjesëmarrjen e ulët në referendum kundër ndarjes së re territoriale
Marveshja e Majit në vitin 2007	Paqartësia e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit	VMRO-DPMNE dhe BDI	Negociatat midis liderëve të VMRO-DPMNE-së dhe BDI-së
Kriza Parlamentare e dhjetorit të vitit 2012	Boshllëqe ligjore dhe paqartësi në Rregulloren e Kuvendit të RM-së dhe Ligjin për Kuvendin e RM-së, miratimi i Buxhetit për vitin 2013, nivel i ulët i kulturës politike	Partitë politike në Kuvend të bllokut etnik maqedonas (LSDM dhe VMRO-DPMNE-së më shumti)	Me propozim të Presidentit të RM-së themelohet Komision, ndërsa me mbështetje nga komuniteti ndërkombëtar - Raporti i Komisionit i pranuar nga Kuvendi i RM-së
Bojkoti i Kuvendit nga LSDM në vitin 2014	Parregullsi zgjedhore	LSDM, VMRO-DPMNE, Kuvendi i RM-së	Kriza vazhdon

## **Qeveria teknike, qeveria e parë politike në RM dhe bojkoti i parë i Parlamentit**

Vetë pavarësia e Republikës së Maqedonisë dhe periudha që vijoi gjatë dhe pas formimit të qeverisë së parë teknike më 21 mars viti 1991, shënoi zhvillimin e proceseve të reja, të cilat që në fillim ishin të shoqëruara nga krizat intensive në dialogun politik në vend. Edhe pse zgjedhjet e para shumëpartiake në nëntor të vitit 1990 fitoi VMRO-DPMNE me 38 mandate nga 120, kjo parti nuk ishte në gjendje të sigurojë mbështetje në Kuvendin e RM-së për formimin e qeverisë. Në fakt, asnjë parti nuk ishte në gjendje për të formuar qeverinë e vet, ose për të ardhur në mbështetjen e nevojshme, prandaj u qas drejt formimit të qeverisë teknike. Nga kjo rrugë pa krye në dialogun politik, u dol përmes formimit të një qeveri teknike të drejtuar nga Nikola Kljusev, e cila numëron 22 ministra të propozuar nga disa parti. Mandati i saj përfundoi më 7 korrik të vitit 1992, kur asaj iu votua mosbesim, ndërsa kjo ngjarje u pasua nga një prej mangësive më të mëdha kushtetuese në historinë kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.<sup>31</sup>

Formimi i qeverisë së dytë maqedonase në Republikën e Maqedonisë gjithashtu nuk kaloi pa polemika. Ajo u themelua më 4 shtator të vitit 1992, dhe në krye të saj erdhi Branko Crvenkovski. Më shqetësuese ishte se Presidenti i RM-së tri herë dha mandatin bartësve të ndryshme. Gjegjesisht, pas dhënies të mandatit liderit të atëhershëm të VMRO-DPMNE-së, Lupço Georgievski, ai nuk arriti të mbledh shumicën e nevojshme për mbështetje të qeverisë, dhe u detyrua të kthejë mandatin. Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Kiro Gligorov, mandatin ja besoi Peter Goshev të LSDM-së, i cili pësoi një fat të ngjashëm si Georgievski. Përpjekja e tretë e Gligorov ishte e suksesshme kur mandatin ja besoi Branko Crvenkovskit, i cili formoi qeverinë me 22 ministra nga katër parti politike - LSDM, PPD, PL dhe Partisë Socialiste. Kjo qeveri është mbajtur deri në nëntor, 1994 dmth

---

31 Për problematikën e ligjit Kushtetues dhe shkelje të saj shiko: Shkaric, Svetomir dhe Siljanovska, Gordana. E drejta kushtetuese. Shkup: Kultura, 2009. str.684.

deri tek mbajtja e zgjedhjeve të dyta parlamentare që sollën bojkotin e parë të Kuvendit nga njëra prej partive më të mëdha politike në Maqedoni.

Në zgjedhjet e dyta parlamentare në Nëntor, 1994 fitoi “Bashkimin për Maqedonisë”, dmth koalicioni i tre partive - LSDM, PL dhe Partisë Socialiste. Përveç këtyre tre parti në qeverinë e re të formuar më 20 dhjetor 1994 hyri dhe PPD-ja. Qeveria numëronte 21 anëtarë, ndërsa ndodhi edhe një kuriozitet - PL edhe pse kishte katër nga ministrat e saj sidoqoftë nuk e mbështeti qeverinë për shkak të mospajtimit politik me partitë e tjera.

Karakteristik kryesore e kësaj periudhe politike të zhvillimit të RM ishte bllokimi i parë më serioz në dialogun politik në Maqedoni. Gjegjesisht, edhe pse VMRO-DPMNE dhe Partia Demokratike ishin dy partitë që fituan numrin më të madh të votave për mandate në Kuvend pas rrethit të parë të zgjedhjeve (VMRO-DPMNE - 14,3% dhe PD - 11%), ata gjithsesi vendosën të bojkotojnë rrethin e dytë të zgjedhjeve (modeli me shumicë me dy raunde në atë kohë), për shkak të pakënaqësisë me procesin zgjedhor, për të cilin akuzuan se është jokorrekt dhe i mbushur me parregullsi zgjedhore. Kjo ishte precedent në RM, me çka përbërja parlamentare e Kuvendit të RM-së katër vjet punoi pa praninë e këtyre partive në karriget parlamentare, e cila gjithashtu përfaqëson bojkotin e parë të institucioneve të Republikës së Maqedonisë dhe fillimin e luftës politike jashtë-institucionale.

## **Kriza e vitit 2001**

Kriza më e thellë që Maqedonia ka kaluar që nga pavarësia e saj ishte, sigurisht, konflikti në vitin 2001.<sup>32</sup> Në konflikti në njërën anë morrën pjesë rebelët shqiptarë, ndërsa nga ana tjetër forcat ushtarake dhe të sigurisë të Republikës së Maqedonisë. Veprimet ushtarake filluan në pranverë të vitit 2001 në fshatin Tanushë afër Shkupit, dhe u përhap shumë shpejt në të gjitha

32 Për studim më të detajuar kuantitativ dhe cilësor të krizës në vitin 2001, Ligji për organizim territorial në vitin 2004 dhe Marrëveshja e Majit 2007 shihni në Markovikj, Nenad, Damjanovski, Ivan, Ilievski, Zoran & Bozinovski, Vladimir. „The Role of the European Union in the Democratic Consolidation and Ethnic Conflict Management in the Republic of Macedonia“. Regional Research Promotion Programme, 2011, në dispozicion në <http://goo.gl/DVJiDv>

fushat ku kishte një përqindje të konsiderueshme të popullsisë shqiptare. Si arsye të veprimit ushtarak, rebelët shqiptarë por edhe politikanët dhe intelektualët cituar luftën për të drejtat e njeriut të bashkësis shqiptare në Maqedoni, si dhe dëshirën për të ndryshuar Kushtetutën e vitit 1991 (e cila ishte referuar si shkaktar i krizës). Nga ana tjetër, pala maqedonase e konfliktit e perceptoi si derdhje e konfliktit të Kosovës në vitin 1999 ose si një rebelim i brendshëm i shqiptarëve maqedonas të mbështetur nga strukturat kosovare<sup>33</sup>.

Sa për procesin politik dhe dialogut politik në Maqedoni, në vitin 2001, ishte jashtëzakonisht e vështirë, në kushte të veprimeve ushtarake që u zhvilluan në Maqedoninë perëndimore dhe veriperëndimore. Pas shpërthimit të veprimit ushtarak u bë pothuajse e pamundur që të vendoset proces normal politik prandaj dhe u mbështetet në strategjinë politike e cila ishte e vetmja mënyrë për të siguruar vendosjen e stabilitetit politik – u formua Qeveria për shpëtim kombëtar më 30 maj, të vitit 2001. Qeveria e shpëtimit kombëtar u krijua nga të gjitha partitë parlamentare dhe në të u fut një përbërje e kombinuar e ministrave të LSDM-së, VMRO-DPMNE-së, PDSH-së, PPD-së, PL-së dhe VMRO-Opcioni reformues I vërtetë Maqedonas. Kjo përbërje ishte për të siguruar normalizimin e procesit politik dhe gradualisht qetësimin e veprimeve ushtarake, diçka që do të provojë e pamundur pa angazhimin komunitetit ndërkombëtar .

Gjatë konfliktit të vitit 2001 u dëshmuua rëndësia e komunitetit ndërkombëtar në normalizimin e procesit politik në vend. Gjegjësisht, si lojtarët kryesorë edhe njëherë u imponua BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara të cilat kishin qasje të ndryshme. Përderisa SHBA ka ushtruar presion të drejtpërdrejtë mbi palët ndërluftuese, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, BE-ja ka vepruar më shumë pas konfliktit me ndihmë financiare dhe donacione perms të cilave do të rehabilitohej shteti pas veprimeve ushtarake në rajonet e krizës. Kjo taktikë “shkop dhe karrota” është provuar të jetë efektive, duke pasur parasysh se procesi politik erdhi në kulminacionin e cila në fund siguroi ndërprerjen e aktiviteteve ushtarake në Maqedoni – Marrëveshja Kornizë e Ohrit.

---

33

Ibid.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit u nënshkrua më 13 gusht të vitit 2001, nën kujdesin e Presidentit të Republikës së Maqedonisë - Boris Trajkovski. E nënshkruan liderët e katër partive më të mëdha në Kuvendine RM-së në atë kohë - Branko Crvenkovski (LSDM), Lupço Georgievski (VMRO-DPMNE), Imer Imeri (PPD) dhe Arben Xhaferi (PDSH). Kuriozitet në kontratë është se është nënshkruar në gjuhën angleze por edhe fakti se BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara “garantuan” për kontratën nëpërmjet përfaqësuesve të tyre Fransoa Leotar dhe Xhejms Perdju. Ndonëse MKO bëri shumë precedentë në terma ligjore, gjithsesi me miratimin e saj është ndërprerë kriza më e madhe politike dhe ushtarake në Maqedoni që nga pavarësia e saj.

MKO është e bazuar në disa parime bazë të cilat i referohen:

- Refuzimi i dhunës për të arritur qëllimet politike dhe ruajtjen e karakterit multi-etnik të shtetit;
- Ndërprerja e armiqësive mes dy palëve;
- Zhvillimi i pushtetit të decentralizuar;
- Mosdiskriminim dhe përfaqësim të drejtë;
- Procedura të posaçme kuvendore;
- Arsimi dhe përdorimi i gjuhëve;
- Shprehja e identitetit etj.

Edhe pse gjatë nënshkrimit të MKO-së veprimet ushtarake ende vazhdonin, MKO mundësoi, ato gradualisht të qetësohen dhe gjendja në Maqedoni të normalizohet. Si pasojë e MKO-së në vitin 2002 u zbatua edhe regjistrimi i popullsisë, e cila ishte edhe një nga parakushtet për stabilitetin e mëtejshëm politik në vend. Megjithatë interpretim i ndryshëm i MKO-së nga politikanë, intelektualë dhe ekspertë nga të dy blloqet etnike, paraqiste një gjenerator i krizave të reja politike në Maqedoni në periudhën e pas konfliktit, të cilat megjithatë për nga fuqia ishin shumë më të vogla se kriza e vitit 2001. Krizat që u shfaqën pas miratimit të MKO-së, të cilat rrjedhin nga interpretimit të tij, i referohen Ligjit për organizim territorial në vitin

2004 dhe Marrëveshjes së majit të vitit 2007.

## **Ligji për organizim territorial të 2004**

Zbatimi i MKO-së në periudhën pas konfliktit paraqet një gjenerator të përhershëm të krizve në dialogun politik në vend. Keqkuptim i parë i madh që pothuajse e bllokoi dialogun politik në Maqedoni, ishte Ligji për organizim territorial në vitin 2004. Gjegjesisht, siç parashikohet në dispozitat MKO-së që kanë të bëjnë me decentralizimin, kufijtë komunal në Maqedoni duhej të rishikohen në gjysmën e parë të vitit 2004. Parashikohej zvogëlimi i numrit të komunave prej 120 në 84, me çka duhej rritur numri I komunave me shumicë etnike shqiptare. Kjo shkaktoi një reagim nga ana e maqedonasve, si dhe tek intelektualë dhe aktivistë të njohur të shoqërisë civile, të cilët kundërshtuan këtë shqyrtim, duke e quajtur procesin “gerrymandering etnik”.E sapo sormuara “Lëvizja Civile e Maqedonisë” mblodhi intelektualë të shquar maqedonas, biznesmenë dhe aktivistë në mënyrë që decentralizmi të sillej në referendum dhe nëpërmjet tij këto ndryshime të ndalohen. Referendum i suksesshëm, sipas tyre, është dashur të jetë ai ku të paktën gjysma e popullsisë do të votonin pa marrë parasysh “për” ose “kundër”. Sipas legjislacionit në atë kohë, për të pasuar referendum sukses, duhej deklaruar më shumë se 50% e të gjithë votuesve, e cila ishte sigurisht një sfidë për organizatorët e referendumit. Në kundërshtim me këtë, Qeveria e RM-së e mbështetur nga bashkësia ndërkombëtare, u bëri thirrje njerëzve për të mos dalë në referendum, dhe kështu ai të mos ketë sukses.

Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Branko Crvenkovski në lidhje me organizimin territorial, tha se më shumë është i mbështetur nga bashkësia ndërkombëtare, sesa nga qytetarët maqedonas. Kongresi Botëror Maqedonas, organizatë kombëtare maqedonase (pan-maqedonase) me seli në Shkup, dhe opozita maqedonase e nga VMRO-DPMNE, organizuan mbledhje të 150,000 nënshkrimeve, me qëllim që të shkaktojhet organizim territorial i një referendumit të përgjithshëm. Deri më 23 gusht 2004, u mblodhën 180.454 nënshkrime dhe referendumin u



caktua për në 7 nëntor të atij viti. Argumentet e atëhershme të opozitës ishin se votimi kundër kufijve të reja të komunave në RM nuk është votim kundër MKO-së as kundër aspiratave euro-atlantike të vendit, por është votim kundër mënyrës se si është vendosur për ligji i ri dhe se si është miratuar. Megjithatë, BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara shprehën shqetësim rreth vonesës së decentralizimit. BE-ja shprehi shqetësim publik në rast të suksesit të referendumit, ndërsa Shtetet e Bashkuara ishin edhe më konkret duke theksuar se referendumit është një hap prapa.

Koalicioni qeveritar, në atë kohë i përbër nga LSDM dhe BDI, u bëri thirrje qytetarëve të Maqedonisë që të bojkotojnë referendumin me fushatë që ishte titulluar “Disa pyetje nuk meritojnë përgjigje.” Edhe pse bashkësia ndërkombëtare fuqimisht dhe haptazi mbështeti qëndrimin e Qeverisë, sondazhet e opinionit publik vazhdimisht tregojnin se referendumit do të jetë i suksesshëm; shumica e votuesve ishin kundër riorganizimit territorial. Megjithatë, më 4 nëntor të vitit 2004, vetëm tre ditë para referendumit, SHBA për çudi të madhe për publikun vendas e njohi Republikën e Maqedonisë nën emrin e saj kushtetues, që për shumë njerëz kishte një ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatit të referendumit. Referendumi, i mbajtur më 7 nëntor të vitit 2004, pësoi dështim për shkak të pjesëmarrjes së dobët prej 26,58% edhe pse 94,01% e votuesve votuan kundër auditimit kufijve komunalë. Vëmendje e plotë e publikut vendas ishte tërhequr kah njohja e Maqedonisë nën emrin e saj kushtetues nga SHBA, me çka problemi me organizimit territorial dhe decentralizimin ra në sfond. Kjo do të thotë se dialogu politik praktikisht nuk erdhi, dhe kriza politike përfundoi me referendumin e pasuksesshëm.

## **Marrëveshja e Maj të vitit 2007**

Një prej shembujve më ilustrues të ngadalsimit të dialogut politik në Maqedoni, dhe si pasojë e drejtpërdrejtë e paqartësive të MKO-së ishte rasti i të ashtuquajturës “marrëveshja e majit” në vitin 2007. Gjenerator i krizës ishte vetë MKO-ja cila nuk përmban dispozita të veçanta rreth asaj se cilët faktor politik duhet të formojn Qeveri pas zgjedhjeve parlamentare,

edhe pse deri më vitin 2006 ishte një rregull i pashkruar se Qeverin do ta formonin fituesit në dy kampuset etnike në Maqedoni, dmth partija maqedonase fituese në zgjedhje dhe partija shqiptare fituese në zgjedhje. Megjithatë, në vitin 2006, Qeveria u formua nga fituesi në kampusin etnik maqedonas - VMRO-DPMNE, partneri më i vogël i koalicionit gjithashtu nga blloku politik maqedonas - NSDP, por edhe nga partia e në zgjedhjet parlamentare tek shqiptarëve etnikë nuk fitoi më së shumë vende në parlament - PDSH. Kjo shkaktoi një ndjenjë të padrejtësis tek fituesi në bllokun politik shqiptar - BDI, e cila konsideronte se ajo duhej të ishte pjesë e qeverisë (i cili përfundimisht edhe u bë, por vetëm pas zgjedhjeve të reja parlamentare në vitin 2008).

Fillimi i menjëhershëm i krizës mund të gjendet më 26 janar v.2007, kur ligjvënësit e BDI-së lëshuan Kuvendin e RM-së në shenjë proteste mbi legjislacionin që u miratua me parimin e Badinterit, por pa votat e tyre. Kjo do të thotë se shumica e votave të bashkësive pakicë në Kuvendin e RM-së është siguruar përmes votave të deputetëve të PDSH-së dhe anëtarëve të tjerë të bashkësive pakicë nga partitë e tjera. BDI-a reagoi duke e lënë Kuvendin e RM-së dhe menjëherë kërkoi negociata në nivel “ndëretnik” me Qeverinë si parakusht për kthimin e tyre në Kuvend. Kjo do të thotë sjelljen e një liste të ligjeve që do të duhej votuar me shumicë të Badinterit, por edhe ligj për UCK-n me të cilën do të merrnin të drejta të barabarta me forcat e sigurisë të RM-së, me të ata u përleshën në vitin 2001.

Bashkësia ndërkombëtare, e përfaqësuar nga BE-ja dhe NATO, ushtruan presion shtesë për marrëveshje mes faktorëve politikë në vend me atë që kushtëzoi RM-së me ftesen për anëtarësim në NATO dhe fillim të negociatave me BE-në. Presione erdhën edhe nga Komisioni Evropian ku kjo çështja gjeti vendin e saj në raportet e progresit të RM-së që Komisioni Evropian i përgatit çdo vit.<sup>34</sup>

Edhe pse një marrëveshje formale nuk ishte kurrë në dispozicion të publikut, as erdhi deri tek nënshkrimi e tij formal, mediat në Maqedoni paraqitën një dokument që përmbante pesë pikë, të cilat liderët e VMRO-

---

<sup>34</sup> Shiko si shembull Commission of the European Communities. The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2007 Progress Report.Brussels, 6.11.2007.SEC (2007) 1432.në dispozicion në <http://goo.gl/s4Kc6F> стр.6-7.

DPMNE-së dhe BDI-së, Nikolla Gruevski dhe Ali Ahmeti ranë dakord:

1. Partitë ranë dakord për një listë prej 46 ligjeve që do të jenë subjekt i votimit të parimit të Badinterit, i cili do të përfshihet në Rregulloren e Kuvendit të RM-së

2. Partitë ranë dakord për të zëvendësuar një anëtar të Komisionit Parlamentar për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive prej VMRO-DPMNE-së me një anëtar të LSDM-së dhe të përgatitet propozim për përbërje të re të këtij organi;

3. Partitë ranë dakord për të adresuar problemin e sigurimit të ndihmës financiare dhe sociale për viktimat e konfliktit të vitit 2001 dhe familjeve të tyre në kuadër të ligjeve dhe procedurave ekzistuese. Palët ranë dakord të vazhdojnë të adresojn këtë çështje nëpërmjet formimit të një grupi punues.

4. Partitë ranë dakord për të përgatitur dhe për të futur Ligj mbi përdorimin e gjuhëve në Kuvendin e RM-së e cila është në përputhje të plotë me MKO-në dhe Amendamentin e 5-të të Kushtetutës. Për këtë çështje gjithashtu u ra dakord që të formohet një grup punues.

5. Pas kthimit të BDI-së në Kuvend, partitë ranë dakord të vazhdojnë diskutimet në mënyrën e formimit të Qeverisë në Republikën e Maqedonisë.<sup>35</sup>

Arritja e kësaj marrëveshjeje rezultoi me kthimin e të gjithë deputetëve të BDI-së në Kuvendin e RM-së më 30 maj të vitit 2007 dhe normalizimin e dialogut politik dhe situatës në vend. Nuk ka dyshim se normalizimi i marrëdhënieve do të kishte qenë shumë e vështirë pa presionet që vinin nga SHBA dhe BE, dmth që këta faktorë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në normalizimin e situatës. Kjo për here të parë ishte edhe mundësi për angazhim më të drejtpërdrejtë të BE-së si një lojtar kyç në ndërmjetësimin midis faktorëve politikë me çka u inponua si aktor serioz në skenën politike në vend. Dëshmi se kontrata ishte e respektuar ishte formimi i Qeverisë pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2008 ku Qeverinë e formuan VMRO-DPMNE dhe BDI, dmth fituesit e dy blloqeve politike etnike. Edhe pse ky rregull nuk është formalizuar, duket se pas kësaj krize,

ky rregull është u forcua si rregulla më e fuqishme pashkruar në skenën politike në RM.

## **Kriza parlamentare në dhjetor 2012**

Edhe pse kriza parlamentare në dhjetor të vitit 2012 është marrë si një studim i një rasti të veçantë në këtë manual, duke dhënë një përshkrim të shkurtër të ngjarjeve brenda kronologjisë së krizës së dialogut politik në Maqedoni duket e dobishme.

Kriza më 24 dhjetor të vitit 2012 që filloi në Kuvendin e RM-së, apo e ashtuquajtura “e hëna e zezë” në të vërtetë filloi në Komisionin për Financim dhe Buxhet të Kuvendin e RM-së gjatë miratimit të buxhetit për vitin 2013. Si pjesë e procesit parlamentar, dialogu politik brenda Komisionit erdhi në një rrugë pa krye në momentet kur deputetët e opozitës paraqitën 1200 amandamente të Buxhetit të RM-së për vitin 2013, duke deklaruar se buxheti është joproduktiv dhe përplotë me shpenzime që nuk nxitin rritje ekonomike.

Duke pasur parasysh procedurat parlamentare për punën e komisioneve dhe seancave të Kuvendit, u bë e qartë se buxheti nuk mund të miratohet në procedurë të rregullt, me çka u rrezikon shërbimi i borxhit të jashtëm të Republikës së Maqedonisë por edhe buxheti për zgjedhjet lokale të vitit 2013, si pozicionet të rëndësishme buxhetore. Kjo çoi shumicën në pushtet në disavantazh, dmth pozitë në të cilën buxheti ose nuk do mund të miratohej në kohe ose do duhej sjellëme shkelje të rregullave. Duke pasur parasysh se procedurat kërkojnë komisionet të kryejn punën e tyre para se të caktohet seanca plenare për rishikimin e buxhetin, ishte e qartë se procedura ishte shkelur vetëm me atë se u caktua seancë më 24 dhjetor, duke qenë se komisionet përgjegjëse nuk kishin përfunduar ende me punë.

Revoltuar nga ky veprim, deputetët e opozitës bllokuan foltoren para fillimit të seancës dhe ka hynë në një argument me Kryetarin e Kuvendit.

Kjo çoi deri tek reagimi i sigurimit e cila me forcë fizike i largoi deputetët e opozitës nga salla e kuvendit.

Kriza u zgjidh me formim të komisionit me propozim të Presidentit të Republikës së Maqedonisë, në të cilën hyrën dy përfaqësues të opozitës, dy përfaqësues të qeverisë dhe me të kryesonte Dekani i Fakultetit Juridik. Komisioni pas një seance të gjatë miratoi një raport i cili u dorëzua dhe u pranua nga Kuvendi i RM-së.

## **Lëshimi i Kuvendit nga LSDM-ja dhe PDSH-ja në vitin 2014**

Kriza e fundit politike në vend ka ndodhur pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Maqedoni në vitin 2014. Ata u mbajtën paralelisht me zgjedhjet presidenciale ku fitoi kandidati i VMRO-DPMNE-së dhe Presidenti I deriatëhershëm i RM-së -Gjorge Ivanov. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare u mbajtën më 27 prill 2014, dhe pas numërimit të rezultateve fitues u shpall koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, me 42,98% të votave dhe 61 vende në parlament nga 123. LSDM fitoi 25,34% të votave dhe 34 vende, ndërsa BDI fitoi 13,71% të votave dhe 19 vende. Partitë e tjera që fituan mandate janë PDSH (me mbështetje prej 5,92%) me 7 mandate, ishte RDK me mbështetje 1,59% dhe një mandate dhe GROM me mbështetje prej 2,82% dhe gjithashtu një mandat.

Pas zgjedhjeve, opozita LSDM bojkotoi e Kuvendin e RM-së me arsyetimin se zgjedhjet nuk ishin fer dhe demokratike dhe me vërejtje të shumta për procesin zgjedhor. Edhe pse pas bojkotit, liderët e dy partive më të mëdha në Maqedoni, LSDM dhe VMRO-DPMNE-së u përpoqën për të negociuar kthimin e LSDM-së në parlament, këto negociata mbetën pa sukses të rëndësishëm.

Përveç kësaj, më 26 gusht 2014 në kuadër të Komsionit për Financim erdhi edhe deri tek përleshje fizike disa anëtarëve të BDI-së dhe PDSH-së. Grindja verbale në mes të dy deputetëve u shndërrua në rrahje masive, e

cila, edhe pse ishte e penguar, rezultoi në tensione të mëtejshme, madje duke pasur parasysh mundësinë që PDSH-ja të lëshon parlamentin. Nëse kjo ndodh, kjo do të thotë se përbërja aktuale e Kuvendit do të punojë përsëri pa opozitë (si në vitin 1994) në qoftë se nuk merren parasysh tre deputetet të cilat nuk ishin dakord me lëshimin e Kuvendit nga ana e opozitës LSDM.

## **KULTURA E DIALOGUT NË RM**

Dialogu politik ndër-partiak është thelbësor në fushën e partive politike. Megjithatë, ky proces nuk zhvillohet nën një zile qelqi dhe as nuk është i mjaftueshëm në vetvete. Qëndrueshmëria e dialogut politik varet nga proceset ku qytetarët, në fund të ditës, do të legjitimojnë situatën në të cilën partitë politike përveç ndeshje, tregojnë edhe gatishmëri për bashkëpunim. Në këtë kuptim, opinioni publik mund të shihet si një tregues se si qytetarët e perceptojnë procesin e vendim-marrjes dhe se në qfarë mase e njohin bashkëpunimin si karakteristikë të rëndësishme të procesit politik.

Pas bojkotit të Kuvendit të zgjedhjeve në vitin 2014 nga ana e LSDM-së, Institutit për Demokraci “Societas Civilis” - Shkup (IDSCS) ka kryer një studim në terren prej 1.000 të anketuarve për të testuar opinionin publik në temën dialogu politik. Fokusi kryesor i hulumtimit ishte dialogu në Kuvend si hapësirë themelore në të cilën partitë takohen dhe është një nga vendet qendrore të procesit politik. Përveç kësaj, hulumtimi përfshinë opinionin për aktorër të tjerë, përveç partive politike, të cilat mund të ndikojnë në përmirësimin e klimës.<sup>36</sup>

Sipas më shumë treguesve rezultatet tregojnë se publiku legjitimizon proceset në të cilat partitë hyjnë në proces të bashkëpunimit dhe tolerancës si bazë për përmirësimin e dialogut politik. Sipas qytetarëve, vlerësimi i gjendjes së dialogut politik në vend është 4,5 në një shkallë prej 1 deri më 10. Kjo tregon se dialogu politik në vend është vlerësuar diçka nën gjysmën

---


<sup>36</sup> IDSCS: “Opinionin publik mbi bojkotin e opozitës, dialogun politik dhe gjendja ndëretnike në Republikën e Maqedonisë” në dispozicion në <http://goo.gl/9OySSR> (qasur më: 01.09.2014)

e shkallës. Ndërsa notat më të ulëta, mesatarisht, vijnë nga më të rinjtë dhe njerëzit me arsimim më të lartë.


Rëndësia e Kuvendit si forum për dialog ndër-partiak, sipas mendimit të publikut, është treguar nga fakti se shumica e qytetarëve (76,5%) besojnë se shumica parlamentare është e nevojshme të jetë më e përgjegjshme ndaj pikëpamjeve të opozitës. Ky mendim është më i shpeshtë në mesin e njerëzve më të arsimuar se sa tek ata më pak të arsimuar, si dhe të punonjësit e sektorit publik dhe tek ata me të ardhura më të larta.

A mendoni se shumica në parlament duhet të jenë më të përgjegjshëm ndaj pikëpamjeve të opozitës?

■ Po ■ Jo ■ Nuk e di



Në drejtim të ngjashëm silltet edhe mendimi se Kuvendi nuk mund të sjellë ligje cilësore pa opozitë. Mendimi i tillë kanë shprehur 53,6% e qytetarëve, gjë që tregon që ata e konsiderojnë opozitën si një pjesë integrale të punës së trupit ligjvënës, dhe prandaj edhe si pjesë e procesit të vendim-marrjes brenda institucionit. Përsëri, qytetarët me arsimim më të lartë në masë më të madhe e përkrahin këtë mendim.



A mendoni se Kuvendi pa praninë e opozitës mund të sjellë ligje cilësore?

■ Po ■ Jo ■ Nuk e di

Megjithatë, 46,1% kundrejt 39,7% e qytetarëve mendojnë se Kuvendi duhet të vazhdojë të punojë pa opozitën. Ashtu si në pyetjen e mëparshme, qytetarët me arsimim më të lartë janë më pak dakord se Kuvendi duhet të vazhdojmë të punojë pa opozitë.

Si pengesë më e madhe për zhvillimin e dialogut politik qytetarët identifikojnë tre fenomene kryesore. Pothuajse një e treta e popullsisë (31,7%), si pengesë më të madhe për dialogun politik shoin nivelin e ulët të tolerancës mes kundërshtarëve politikë. Përveç kësaj, në masë më të madhe është shënuar edhe ndarja etnike (26,5%) dhe politizimi i shoqërisë (28,4%).

Në këtë kuptim, edhe qytetarët përdorin kornizën përmes të ciliës ndarjet etnike shihen si problem i pandarë e dialogut politik. Kështu, nga perceptimet e qytetarëve mund të dallojmë dy nivele të krizës politike të dialogut. E para është afat- gjate, në rrënjët e saj shtrihet ndarja e hapësirës politike në blloqe etnike. E dyta mund të quhet e rastësishme, dhe e njëjta të paktën për tani duket se shfaqet periodikisht, ndërsa në rrënjën e saj qëndron mosmarrëveshje e thellë për çështje të caktuara ose pëe kushtet e konkurrencës politike midis partive.

Nëse ne e pranojmë këtë kornizë, atëherë perceptimet e qytetarëve mund të ndahen në dy grupe kryesore: ata qytetarë tek të cilët problem më i rëndësishme i dialogut politik është ndarja etnike dhe ata të cilët politizimin e shoqërisë e identifikojnë si pengesë kryesore. Në këtë kuptim, mungesa e tolerancës është një faktor që kontribuon në të dyja gjendjet.

Parë nga aktorët e procesit politik, shumica e qytetarëve (56,7%) thonë se partitë janë më përgjegjëse për përmirësimin e dialogut politik. Për këtë pyetje nuk ka korrelacionet veçanërisht të rëndësishme mes kategorive të ndryshme të qytetarëve dhe rezultateve të përgjithshme, që sugjerojnë pranim të përgjithshëm të këtij opinioni nëpër profilet të ndryshme të publikut. Ky qëndrim i qytetarëve është në përputhje me kuadrin e përgjithshëm të manualit, duke theksuar parimin që dialogu politik është një zonë kryesisht në fushën e jetës ndër-partiak, prandaj partitë, të cilat janë aktorë kryesorë që e lëvizin dhe mbajnë në jetë këtë proces.

Përveç kësaj, kur qytetarët u pyetën për institucionet e tjera që mund



të jenë përgjegjëse për zhvillimin e dialogut politik, ata konsiderojnë se përgjegjëses në masë më të madhe janë Qeveria dhe ministrinë (37,9%), ndërsa në shkallë më të vogël janë të listuara Kuvendi dhe deputetët (27,3%) ndërsa Presidenti - 13%. Duke analizuar rezultatet, mund të përfundohet se qytetarët kryesisht presin mbajtësit e përmirësimit të jenë udhëheqësit e shumicës, të cilët zakonisht gjenden në majat e ekzekutivit.

Rezultatet e sondazheve të opinionit publik tregojnë mbështetje të përgjithshme për proceset politike që tregojnë përfshirjen e të gjithë aktorëve relevantë partiak edhe të shumicës qeverisëse edhe të opozitës. Kështu, opinionin publik në Maqedoni është në favor të aktiviteteve që kanë për qëllim tejkalimin e krizës politike, por edhe më përgjithësisht - aktivitete shenjë identifikuese e të cilave janë bashkëpunimi politik si proces paralel i konkurrencës në mes të partive politike. Megjithëse mbështetja për këtë është e përgjithshme, mbështetësit kryesorë të procesit gjithëpërfshirës politik dhe dialogut janë qytetarë më mirë të arsimuar, që është grup demografik që vazhdimisht po rritet në Maqedoni dhe elektorat i rëndësishëm që do tu jep legjitimitet aktiviteteve bashkëpunuese.

Megjithatë, këta tregues duhet të shihen edhe nga një kontekst më i gjerë i kulturës politike në Maqedoni. Edhe pse rezultatet që sugjerojnë mbështetje për dialog janë inkurajuese, është e rëndësishme të theksohet se ka faktorë rëndues.

Në një studim të IDSCS për kulturën politike në Maqedoni një nga konkluzionet është që ekziston nivel i ulët i besimit ndërpersonal.<sup>37</sup> Vetëm një në çdo 10 qytetarë konsideron që njerëzive të tjerë mund tu besohet. Ky është një faktor i rëndësishëm për mundësitë e dialogut politik, sepse besimi është themeli për dialog të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm në mes të partive, por edhe në përgjithësi - besimi është bazë për ndërtimin e një zhvillimi të qëndrueshëm demokratik.

Përveç kësaj, faktor rëndues është perceptimi se kush dhe në çfarë mënyre është më mirë të mirren vendime në sistemin politik. Përfundimi kryesor i studimit është se intelektualët dhe ekspertët duhet të ketë një

37 Markovic, N., Troshanovski, M., Popovikj, M., Misev, V., 2012. Political culture in Macedonia. Fridrich Ebert Stiftung, Skopje.

vend më të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes, se sa partitë dhe politikanët,. Faktorët që ndikojnë tek ky qëndrim është mosbesimi i lartë në institucionet (edhe tek politikanët) dhe ndërgjegjësimi i ulët demokratik që nuk i sheh politikanët si organizatorë të procesit deliberativ. Në këtë kuptim, procesi deliberativ, në sytë e qytetarëve merr rëndësinë dytësore, me çka humben mundësitë të cilat ky proces mund ti sjellë dhe zëvendësohet me teknokraci. Edhe pse në çdo proces deliberativ mendimi ekspert duhet përfshirë dhe respektuar, megjithatë ky proces është politik, në të cilin partitë si aktorë në vendimmarrje duhet të organizojnë dhe të kanalizojnë debatin.

Në një mënyrë të ngjashme është përfundimi se si një politikan ideal duhet të veprojë. Gjysma e qytetarëve mendojnë se politikanin ideal duhet të përdor njohuri dhe ekspertizë, ndërsa vetëm 27% e qytetarëve mendojnë se ai duhet të përdorë konsultime dhe debate. Një e pesta e qytetarëve mendojnë se politikanin ideal duhet të ketë vullnet të fortë që të realizoj vendimet e veta. Këto qëndrime janë komplementare me atë se kush duhet të sjellë vendimet në sistemin politik dhe shpreh më pak mbështetje për procesin deliberativ, dhe më shumë për procesin e marrjes së vendimeve në bazë të autoritetit - në një masë më të madhe, autoritet profesional, por edhe në masë të konsiderueshme, autoritet politik.

Duke parë në të dy studimet së bashku ato tregojnë një gjendje komplekse të kontradiktave. Fotografia e përgjithshme e kulturës politike është që deliberimi (si bazë për dialog) është parë si sekundare, pra dora e fortë e liderëve, dhe autoriteti duhet të jenë faktorë kyç në procesin e vendim marrjes. Përveç kësaj, pengesë për dialogun është mosbesimi i përgjithshëm dhe i përhapur në mesin e njerëzve. Në anën tjetër, në rast të një krize politike që lidhet me dialogun politik, rezultatet e hulumtimit të opinionit publik tregojnë mbështetje për dialog dhe relativisht një fotografi të qartë për rëndësisë e aktorëve të përfshirë në proces.

Megjithatë, pika e vetme përbashkët e këtyre kontradiktave është pritja se sistemi politik duhet të funksionojë. Në këtë kuptim, pikëpamjet mund të vihet në kontekst ndryshe në raste të ndryshme. Kur kriza politike dhe mungesa e bashkëpunimit ndër-partiak është e qartë, opinionin politik fokusohet në identifikimin e proceseve që do të tejkalojnë këtë hendek.

Në anën tjetër, në rast se mungon problem i qartë në bashkëpunimin mes partve, mosbesimi në efektivitetin e institucioneve për të shërbyer nevojat e qytetarëve, është udhëzues primar i opinionit publik.

## AKTORËT KRYESORË

Kur është fjala për aktorët kryesorë në dialogun politikë ndër-partiak – prtitë, është e nevojshme që të shikojmë në dy aspekte të natyrës së tyre që janë të rëndësishme: dialogu Brenda në parti dhe rangun e aktorëve që i përfaqësojnë partitë politike në shoqëri.

Demokracia e brenda në parti luan rol të rëndësishëm në formësimin e dialogut politik, dmth në probabilitetin që ai të ket sukses. Partitë politike marrin pjesë në jetën politike duke përfaqësuar ideologjit dhe intereset e përbashkëta të anëtarëve të tyre. Këto janë supozimet themelore të zhvillimit gjithëpërfshirës të partisë si një organizatë në fushën politike paraqet një pozicion të qëndrueshëm që e ndërton në kundërshtim me lojtarët tjerë. Demokracia Brenda në parti, në këtë mënyrë stabilizon imazhin e partisë por edhe të spektrit politik në vend dhe zvogëlon efektin e vulës personale të liderëve, që ata shtojnë për të krijuar situatë në të cilën partia është udhëhequr nga interesat personale të një pakice. Kështu, harmonizimi midis partive përmes dialogut politik zgjat më shumë dhe më pak nvaret nga marrëdhëniet personale midis elitave partiake.

Megjithatë, analizat tregojnë se demokracia brenda partisë në Republikën e Maqedonisë është i kufizuar. Karakteristikë më evidente e hierarhisë së fortë dhe centralizimit të partive politike në Maqedoni është pozita e liderit të partisë, e cila është fytyra e partisë për publikun dhe ka pushtet të konsiderueshëm.<sup>38</sup> Përveç kësaj, deputetët rrallë herë tregojnë pavarësi në raport me pozicionet e miratuara paraprakisht në parti.<sup>39</sup>

38 Cekov, A., Daskalovski, G., 2013. Analiza e demokracisë së brendshme të partive në Maqedoni. Fondacioni Konrad Adenauer, Shkup.

39 Ibid

Kjo situatë tregon qartë se hapësira funksionale për dialog politik në RM janë takime të udhëheqësve, dhe pjesëmarrja e deputetëve si përfaqësues të qytetarëve është minimale. Kjo nuk është domosdoshmërisht dekurajuese, dhe dialogu politik i projektuar mirë siguron përfshirjen e më shumë niveleve: nga njëra anë pjesëmarrje e deputetëve, por në anën tjetër dhe organet qendrore të partive dhe elitave të tyre. Megjithatë, situata tregon se në kohën e duhur, dialogu politik do të varet nga udhëheqësit e partive, në fakt prej gatishmërisë së tyre për bashkëpunim dhe besim të ndërsjellë. Në të njëjtën periudhë, ai më pak do të varet nga zërat e ndryshëm politik brenda secilës parti, pa marrë parasysh se sa ato janë të moderuara ose të drejtuar drejt bashkëpunimit.

Aspekti i dytë i rëndësishëm i mundësive për dialog politik është marrëdhënia e partive drejt atyre që ata përfaqësojnë. Së pari, mendohet për qytetarët, por në të njëjtin kuptim, i referohet edhe aktorëve të tjerë shoqëror, përmes të cilave qytetarët shprehin interesat e tyre, të tillë janë aktorët e shoqërisë civile. Kur flasim për këtë, mendojmë për imazhin që partitë politike e krijojnë për këta aktorë.

Në procesin politik në Maqedoni është i dukshëm paralelizimi i shoqërisë civile. Ky fenomen vërehet në organizatat joqeveritare, sindikatat, odat ekonomike, shoqatat profesionale dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile. Partitë zgjedhin të bashkëpunojnë me aktorë të afërt ,ndërsa mohojnë vërtetësinë e përfaqësimit të kundërshtarëve. Kjo shkakton ndarje brenda procesit politik me çka aspak nuk pranohet pozita kundërshtare në nivele të shumta të procesit të vendimmarrjes - procesi ndërmjet partive dhe pjesa ku organizatat e qytetarëve marrin pjesë.

Ky paralelizim konsiderueshëm pengon mundësitë për dialog politik. Me vet mohimin e vërtetësisë së përfaqësimit të një ideje krijon ndarje të thella - të tilla si ndarja “patriotë dhe tradhëtarë”. Kështu partitë “paraqesin” palën tjetër sikur nuk përket në procesin politik, sepse pozita e tyre nuk rrjedh nga mundësia e pluralizmit të ideve, por është jo autentike - importuar dhe ndërtuar jashtë interesave të qytetarëve. Ky imazh i vënë partitë politike në fund të nivelit në të cilin një dialogu politik mund të fillojë - niveli ku zhvillohet besimi dhe palët ende nuk janë ende të gatshme për të diskutuar për çështje të rëndësishme.

## 1. VMRO-DPMNE

Partia VMRO-DPMNE është deklaruar si demokristiane dhe është parti e qendrës së djathtë të spektrit politik. VMRO-DPMNE është aktualisht partia më e madhe politike në Maqedoni dhe me LSDM-ne janë dy partitë më të mëdha në përgjithësi dhe në veçanti në bllokun politik maqedonas.

Para zgjedhjeve parlamentare në vitin 2006, VMRO-DPMNE adopton Doktrinën e saj të veprimit, që është një dokument i veçantë për vizionin e partisë për shoqërinë dhe shtetin, i cili është bazë për përgatitjen e programeve të partisë dhe zgjedhjeve. Programet zgjedhore të partisë janë të ndara tematikisht dhe përmbajnë kornizë të premtimeve të përgjithshme të përfshira në katalogun e projekteve me afate të caktuara për plotsimin e tyre. Në zgjedhejt e vitit 2006 kjo formë e programit zgjedhor paraqiste risi në skenën politike.

Karakteristikë e VMRO-DPMNE-së është përdorimi i gjerë i marketingut politik në të gjitha fazat e ciklit zgjedhor. Në këtë mënyrë aktivitetet e partisë dhe përfaqësuesit e saj, në të gjitha nivelet e qeverisjes, në Republikë janë vazhdimisht në publik. Përveç aktiviteteve të marketingut për të promovuar punën e partisë, pjesë e strategjisë përfshin fushatë negative kundër partive, organizatave jo-partiake dhe individëve.

## 2. LSDM

LSDM është deklaruar si parti socialdemokratike dhe është parti e qendrës së majtë të spektrit politik. Ajo është partia më e madhe opozitare, dhe aktualisht është parti jasht-parlamentare parti përshkak se bojkoton Kuvendin dhe nuk njeh rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2014. Së bashku me VMRO-DPMNE-në janë partitë më të mëdha në

blokun politik maqedonas. Ajo është udhëheqës i koalicionit të opozitës që përfshin parti më të vogla, duke përfshirë edhe PLD-në.

Vizioni i LSDM-së për shoqërinë dhe shtetin nuk është një pjesë e veçantë, por është pjesë e integruar e programit të partisë. Ngjashëm me VMRO-DPMNE-në kufiri në mes të programit të zgjedhjeve dhe partisë është e hollë. Programi i zgjedhjeve nuk është i orientuar me projekt, por në dy ciklet e fundit zgjedhore është tematike me kornizë të përgjithshme dhe masa specifike të cilat parashihen si premtime.

### **3. BDI**

BDI vjen nga Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK) nga e cila pas konfliktit u formua parti. BDI-ja është partia më e madhe politike në bllokun shqiptar dhe aktualisht është partner në koalicionin qeveritar me VMRO-DPMNE. Partia është deklaruar si parti e qendrës së majtë në spektrin politik.

Perspektiva dominante politike mbi çështjet shoqërore dhe shtetërore në BDI është etniciteti, partia qëndron për përmirësimin e të drejtave të shqiptarëve përmes zbatimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Programi i partisë është zgjedhor, ndërsa parimet dhe vizioni janë të përfshira në fillim dhe përmbajtja nuk është e organizuar si projekt por e përgjithshme.

### **4. PDSH**

PDSH është deklaruar si parti e qendrës së djathtë të spektrit politik, dhe është partia e dytë më e madhe politike në bllokun shqiptar.

Ashtu si tek të gjitha partitë shqiptare, vizioni i veprimit politik të partisë është kryesisht etnik, dhe pas vitit 2001 bazohet në Marrëveshjen

Kornizë të Ohrit, si kornizë për përmirësimin e statusit të shqiptarëve. Nga të katër partitë më të mëdha në Maqedoni, PDSH-ja ka program më pak të zhvilluar për veprim dhe profilizim ideologjik, përtej çështjeve të të drejtave etnike.

## 5. Partitë më të vogla

Përveç sistemit zgjedhor edhe sistemi politik në Maqedoni ka efekt negativ për partitë e vogla. Parimi për koalicion maqedonaso-shqiptar zakonisht mbledh vende të mjaftueshme për shumicë parlamentare, gjë që dekurajon performancën e partive me programe më të vogla, partitve të vogla interesi ose etnike në Maqedoni. Imazh i përgjithshëm i peisazhit të partive është se bëhet fjalë për parti me organizim të dobët, me pak vota dhe program të dobët. Baza e votave të këtyre partive është ose etnike ose klientelë, ndërsa të rralla janë përjashtimet (p.sh. PLD, DOM, GROM). Për këtë arsye, strategjia më e përdorur është partitë të vepronë në koalicione të qëndrueshme para-zgjedhore ku primatin dhe fytyrën e koalicionit e kanë, VMRO-DPMNE dhe LSDM.

## HAPËSIRA FORMALE PËR DIALOG POLITIK

Hapësira formale politike, në të cilën zhvillohet dialogu politik, në shumicën e demokracive moderne varet nga struktura institucionale e sistemit politik. Megjithatë, kryesisht kjo hapësirë formale, në të cilën zhvillohet dialogu politik përbëhet nga Trupi ligjvënës i shtetit, Qeveria dhe Presidenti. Kompetencat që këto tre institucione i gëzojnë, dhe janë të rregulluara me Kushtetutë, paraqesin tërësinë e haësirës formale të dialogut politik. Megjithatë, sipas kompetencave formale, Parlamenti (në rastin tonë – Kuvendi i RM-së) ka një rolin më të madh në dialogun politik, pasi ajo është institucion qëllimi kryesor i të cilit, përveq sjelljes së legjislacionit,

është shkëmbimi i ideve politike në hapësirën formale institucionale, nën disa rregulla të përbashkëta për të gjithë pjesëmarrësit në dialog.

## Kuvendi i Republikës së Maqedonisë

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është mishërim i legjislaturës në shtet, në të njëjtën kohë është edhe bazë institucionale për dialog ndër-partiak. Sipas Kushtetutës së RM-së, Kuvendi është i definuar si “organ përfaqësues i qytetarëve dhe autoriteti legjislativ në Republikën e Maqedonisë”,<sup>40</sup> e cila mund të numëroj në mes 120 dhe 140 deputet<sup>41</sup> dhe ku mandatet e deputetëve zakonisht zgjasin katër vite.<sup>42</sup> Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është njëdhomësh, është në sesion të përhershëm dhe punon me seanca.<sup>43</sup>

Në mesin e përgjegjësive dhe roleve të tjera, roli më i rëndësishëm i Kuvendit, i cili është i lidhur me dialogun ndër-partiak, është funksioni i saj deliberativ. Kuvendi paraqitet si hapësirë institucionale ku partitë politike (dhe jo vetëm ato) të cilat janë të përfaqësuara në Kuvend mund ti përballin argumentet e tyre për çështje të rëndësishme shoqërore.

Ka dy mënyra themelore që janë në dispozicion të deputetëve në Kuvendin e RM-së, të cilat janë të lidhura ngushtë me debatin publik dhe shkëmbimin e argumenteve rreth çështjeve të rëndësishme shoqërore:

- Seancat plenare - Kuvendi është në sesion të përhershëm dhe punon me seanca. Seancat plenare paraqesin mundësi për deputetët

---

40 Neni 61 i Kushtetutës së RM-së në dispozicion në <http://goo.gl/SRj2d8> (пристапено 14.07.2014).

41 Ibid, neni 62. Në kohën e përgatitjes së këtij manuali Kuvendi përbëhet nga 123 deputetë. 120 anëtarë zgjidhen nga modeli proporcional në gjashtë njësi zgjedhore (modeli Dontov) dmth në çdo njësi zgjedhen 20 deputet, dhe tre vendet e mbetura në vendet janë të rezervuara për diasporën, që deputetët e tyre i zgjedh përmes përfaqësive diplomatike dhe konsullore të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit në tre zona (Evropë dhe Afrikë, Amerika Veriore dhe Jugore, Australi dhe Azi).

42 Ibid, neni 63. Përjashtim nga rregulli për kohëzgjatjen e mandatit mund të ndodhë në rast të dorëheqjes së deputetit, revokimit të mandatit parlamentar ose shpërbërjen e Parlamentit, kryesisht për shkak të zgjedhjeve të parakohshme.

43 Ibid, neni 66.



për të shkëmbyer argumente në lidhje me çështjet që janë përgjegjësi e Kuvendit, dhe zakonisht rreth akteve legislative të cilat miratohen nga Kuvendi dhe rregullojnë fusha të rëndësishme të jetës shoqërore.

- Seancat e Komisioneve - Kuvendi formon grupe punuese<sup>44</sup> në të cilat diskutohet më detalisht për legjislacionin e propozuar (janë pjesë e procesit legjislativ) dhe brenda të cilave mbahet debat më i plotë dhe më profesional mbi çështje të caktuara që rregullohen me ligj. Komisionet janë një lloj “filtër” i propozim ligjeve të cilat më pas Kuvendi i miraton në seanca plenare, dmth shërbejnë si hapësirë deliberative për pyetje specifike nga fusha punuese e komisioneve.

Rregullat e deliberimit publik në Kuvendin e RM-së, dmth diskutimet gjatë seancave plenare, kohëzgjatja e adresimeve dhe replikave, si dhe çështje të tjera të lidhura me të folurit publik gjatë seancave të Kuvendit janë të rregulluara me Rregulloren e Kuvendit të RM-së.<sup>45</sup> Gjithashtu, pavarësisht nga dispozitat e përgjithshme të Kushtetutës së RM-së që kanë të bëjnë me organet punuese (komisionet), Rregullorja e Kuvendit të RM-së e rregullon edhe punën e tyre.

Kur flasim për dialog ndërpartiak dhe klimë të favorshme në komisionet për shkëmbimin e argumenteve, mbi çështjet që ata trajtojnë, është interesante të përmenden dispozitat e mëposhtme:

- Formimi i komisioneve dhe përfaqësimi i deputetëve brenda tyre bëhet në varësi të numrit të grupeve parlamentare dhe në pajtim me Ligjin për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat<sup>46</sup>. Kjo siguron përfaqësim adekuat të deputetëve nga parti të ndryshme politike, me etnicitet të ndryshëm dhe gjini të ndryshme në komisione të ndryshme, e cila ofron mundësi për dialog cilësor ndër-partiak ku të gjitha palët kanë mundësi për t’u dëgjuar.

- Trupat punues kanë të drejtë “për të studiuar çështje të caktuara nga fushëveprimi i saj ose përgatitjen e akt propozimeve (...) për të

44 Ibid, neni 76.

45 Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (tekst i konsoliduar). Në dispozicion në : <http://goo.gl/qDSvpP> (пристапено на 14.07.2014).

46 Ibid, neni 18, paragrafi 5.

formuar grupe pune<sup>47</sup> ku “anëtarët e grupeve punuese janë të zgjedhur nga radhët e anëtarëve të trupit punues, deputetët, shkenctarët dhe punëtorët profesional dhe publike, si dhe përfaqësues të organeve të administratës shtetërore dhe organeve dhe organizatave të tjera”<sup>48</sup>. Kjo lë mundësinë e përfshirjes së ekspertëve në fushat e interesit të përgjithshëm, ndërsa adreson çështje specifike brenda fushëveprimit të punës jo vetëm të komisioneve, por edhe Kuvendit.

- Kuvendi mund të delegojë trupat punuese kryesore (komisionet), dhe ne rast se bëhet fjalë për ligj me interes të përgjithshëm dhe organizim të diskutimit publik për legjislacionin për të cilin bëhet fjalë<sup>49</sup>. Në këtë mënyrë hapet mundësia të futet jo vetëm publiku profesional, por edhe publiku më i gjerë në procesin e deliberimit (shqyrtimit) publik, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje të ndjeshme shoqërore.

Pa marrë parasysh se ku zhvillohet deliberimi (shqyrtimi) publik, në komitetet apo në seancat plenare, dhe pa marrë parasysh shkallën në të cilën publiku është i përfshirë, ka disa aspekte qendrore se si duhet të duket deliberimi (shqyrtimi) publik në secilin debat parlamentar:<sup>50</sup>

- Pjesëmarrja - të gjithë qytetarët të jenë të përfshirë në të njëjtin nivel dhe për kenë shans për tu shprehur për çështje të rëndësishme shoqërore;
- Pikëpamjet mbi çështjet që diskutohen duhet të paraqiten me ndershmëri;
- Qëndrimet dhe pretendimet e shprehura duhet të ketë arsyetim të logjikshëm dhe të jenë racionale;
- Vrojtimi i argumenteve gjatë procesit të diskutimit publik duhet të bazohet në të mirën publike;
- Palët që janë të përfshirë në procesin e deliberimit (shqyrtimit)

---

47 Ibid, neni 127, paragrafi 1.

48 Ibid.

49 Ibid, neni 145.

50 Steiner et al (2004: 19-24) në Rasch. 2011

publik duhet të ketë kapacitet për të dëgjuar palën tjetër;

- Palët që janë të përfshirë në procesin e deliberimit (shqyrtimit) publik duhet të nderojnë atë që është duke folur dhe të jenë të gatshëm për të rënë dakord me argument më të fortë se ai veti.

Një nga parakushtet më të rëndësishme për përmbushjen e këtyre kritereve të dialogut politik është mundësia që çdo deputet i Kuvendit të jetë i lirë të shpreh mendimin e vet. Kjo është arsyeja pse Kushtetuta e RM-së parashikon imunitet të deputetit ku “deputetët gëzojnë imunitet”<sup>51</sup> ndërsa “Deputeti nuk mund të përgjigjet penalisht ose të paraburgoset për opinion të shprehur ose për votën e tij në Kuvend”<sup>52</sup> Imuniteti është garanci e rëndësishme i cili ka të bëjë drejtpërdrejt me lirinë e fjalës dhe me të cilën deputetëve ju garantohet liria e fjalës në Kuvendin e RM-së.

Një aspekt i rëndësishëm i deliberimit dhe dialogut politik i lidhur me trupin ligjvënës në Maqedoni, është kanali kuvendor. I formuar fillimisht si kanali i tretë i Radios dhe Televizionit të Maqedonisë në vitin 1991 dhe më vonë u riemërua Kanali i Kuvendit, ai bënë transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave të Kuvendit të RM-së, ndërsa transmeton edhe seancat e trupave punuese. Kjo mundëson përgjegjësi më të madhe publike dhe transparencë të punës së Kuvendit të RM-së, si dhe ndërgjegjësimin e publikut për punën e Kuvendit dhe organeve të tij punuese. Me këtë mundësohet dialog politik i informuar, tek i cili mund të përfshihen qytetarët, gjithashtu duke pasur informacione relevante dhe të sakta rreth procesit legjislativ, por edhe rreth deliberimit (shqyrtimit) të përgjithshëm në Kuvend.

Megjithatë, hapësira formale për dialog politik nuk është i kufizuar vetëm në Kuvendin e RM-së. Këtu, kontribut kanë edhe Qeveria dhe Presidenti i RM-së.

51 Kushteuta e RM-së, neni 64, paragrafi 1.

52 Ibid.

## Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Pushteti ekzekutiv në vend është i ndarë në mes të Qeverisë dhe Presidentit të Republikës së Maqedonisë. Të dy organe kanë rol të veçantë në krijimin dhe drejtimin e dialogut ndër-partiak, i cili buron nga fuqitë e tyre formale (më shumë në rastin e Qeverisë) por edhe prej natyrës së rolit që mbajtësi i fuqisë ekzekutive gëzon (më shumë në rastin e Presidentit të Republikës).

Nëse shqyrtohen kompetencat e Qeverisë së RM-së të parashikuara në Kushtetutë, ekziston përshtypja se ata nuk kanë asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me deliberimin publik dhe dialogun ndër-partiak. Këto kompetenca kanë të bëjnë kryesisht me ekzekutimin e ligjeve në Republikën e Maqedonisë dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të tyre, por edhe politikat organizative në kuadër të autoritetit ekzekutiv me kompetenca të caktuara në politikën e jashtme (njohjen e shteteve dhe qeverive, vendosja e misionëve diplomatike dhe konsullore, propozimet për emërimin e ambasadorëve etj) dhe emërimin dhe shkarkimin e zyrtarëve publikë (dhe prokurorin).<sup>53</sup>

Megjithatë nëse shikohet përtej fuqive formale të Qeverisë së RM-së, veçanërisht procedura për miratimin e ligjeve të parashikuara me Kushtetutë RM-së, si dhe mundësitë që i ofron Rregullorja e Kuvendit të RM-së, arrihet deri në përfundimin se Qeveria e RM-së ka një rol të fuqishëm deliberative e cila në shumë aspekte mund të ndikojë dialogun ndër-partiak në vend. Sa i përket rolit deliberativ të Qeverisë së RM-së në sistemin politik të brendshëm është e rëndësishme të cekem aspektet e mëposhtme:

- Sipas Kushtetutës, Qeveria ka të drejtë të propozoj ligje. Mundësa e Qeverisë që të propozojë ligje nuk flet shumë për rolin e saj deliberues por sugjeron se ajo mund të ndikojë drejtpërdrejt në krijimin e ambientit për deliberim publik duke propozuar ligje që drejtpërdrejt kanë të bëjnë

---

53

Ibid, neni 91.

me këtë çështje (Ligjin për media, Ligji për komunikime elektronike, Kodi Zgjedhor etj). Mundësia për të propozuar ligjenë Kuvendin e RM-së, Qeveria e përdor në masë të madhe dhe madje numrin më të madh të ligjeve e propozon qeveria. Kjo është tendencë edhe në vendet e zhvilluara demokratike, për arsye se ligjet janë duke u bërë më komplekse dhe më të gjera, ndërsa kapaciteti dhe kompetenca e Kuvendit është më e vogël në krahasim me shërbimet profesionale të ministrive të qeverive, veçanërisht kur është fjala për çështje të veçanta.

- Përveç kësaj, qeveria mund të përmirësojë dialogun dhe deliberimin duke mundësuar procedurë më të gjatë në përgatitjen e projektligjeve të propozuara, në vend që të propozon procedurë të shpejtë. Kjo do të mundësojë pjesëmarrje më të gjerë të aktorëve të ndryshëm të hapësirës joformale në dialogun politik dhe të mundëson mundësi të përmirësuara për dialog mes shumicës dhe opozitës në Kuvend.

- Rregullorja e Kuvendit të RM-së parashikon edhe mundësi tjetër përmes të cilës rritet transparenca, përgjegjësia dhe dukshmëria e zyrtarëve të qeverisë dhe mbajtësit e funksioneve publike në situata kur deputetët gëzojnë të drejtën për pyetje parlamentare. Domethënë, është e drejte e cila gjatë séances e cila thirret të enjten e fundit të muajit “Deputeti (...) Kryetarit të Qeverisë (Qeveria), anëtarëve të Qeverisë dhe zyrtarëve të tjerë publikë të cilët janë përgjegjës para Kuvendit u bën pyetje në lidhje me punën e tyre apo veprat e juridiksionit të tyre”.<sup>54</sup> Kjo qartë rrit mundësinë e dialogut ndër-partiak duke qenë se pyetjet parlamentare shërbejnë si mundësi për deputetët të hapin tema para publikut, që shpesh mbeten në fushën e ekzekutivit, dhe për të cilat publiku i përgjithshëm ka qasje të kufizuar. Gjithashtu pyetjet parlamentare dhe veçanërisht mundësia e një pyetje shtesë për tre minuta pas marrjes së përgjigjes<sup>55</sup> (të folur ose të shkruar<sup>56</sup>), hap hapësirë për dialog ndër-partiak, shkëmbim të argumenteve dhe hapjes së temave jetike që kanë të bëjnë me punën e ekzekutivit.

54 Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (tekst i konsoliduar). Neni 37, paragrafi 1.

55 Ibid, neni 43.

56 Kjo çështje është e rregulluar me nenet 38-42 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

- Rregullorja e Parlamentit ofron një mundësi tjetër, e cila jo vetëm rrit kontaktin midis pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, por edhe parashikon mundësinë e përfaqësuesve të ekzekutivit për të marrë pjesë në shkëmbimin publik të argumenteve në lidhje me legjislacionin që sjell Kuvendi. Gjegjesisht, “në takimin e trupit punues mund të marrë pjesë, përfaqësuesit, ose i besuar i Qeverisë, përfaqësues i ndonjë organi shtetëror kur në seancë bëhet fjalë për çështje të fushëveprimit të tyre, si dhe çdo propozues ligji propozimi i të cilit është duke u shqyrtuar .“<sup>57</sup>”Gjithashtu,” në seancë të trupit punues kur shqyrtohet një projekt ligj apo një akt në leximin e dytë duhet të jetë i pranishëm dhe të marrë pjesë në punën një përfaqësues i qeverisë dhe një përfaqësuesi i propozuesit propozimi të cilit është nën shqyrtim.<sup>58</sup> Me këtë është e qartë se i jepet mundësi përfaqësuesve ose të besuarve të Qeverisë ose përfaqësuesve të departamentit shtetror për të marrë pjesë në diskutimet e trupave punuese (komisioneve) përgjegjëse për përmirësimin profesional dhe amendamentimi e teksteve ligjore. Kjo rrit mundësinë e zyrtarëve dhe të besuarve të Qeverisë për të kontribuar, si dhe përfaqësuesit e administratës shtetërore, profesionalisht të kontribuojn jo vetëm në përmirësimin e teksteve ligjore, por edhe për të shkëmbyer argumente për çështjet kundërthënëse apo problematike brenda një çështjet ligjore. Edhe pse ata formalisht nuk kanë të drejtë vote për dallim nga anëtarët e trupave punuese, kontributi i tyre mund të jetë vendimtare për të përmirësuar procesin legjislativ dhe shkëmbimin e argumenteve si dhe sqarimin e disa pikave të diskutueshme.

## Presidenti i Republikës

Përveç Qeveria, mbajtës i pushtetit ekzekutiv në shtet është Presidenti i Republikës. Edhe pse pushteti ekzekutiv është i ndarë në mes të dy qendrave të fuqisë, autoriteti dhe natyra e detyrës së Presidentit të Republikës është

---

57 Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (tekst i konsoliduar). Neni 121, paragrafi 1.

58 Ibid, neni 121, paragrafi 2.

e ndryshme nga ajo e Qeverisë. Ndër kompetencat më të rëndësishme të Presidentit është se ai është komandant suprem i forcave të armatosura të Republikës së Maqedonisë dhe përfaqëson Republikën.<sup>59</sup> Ai zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta me votim të fshehtë dhe mandati i tij zgjat pesë vjet.<sup>60</sup> Përzgjedhja bëhet në dy raunde, ku në raundin e dytë kualifikohen dy kandidatët që kanë marrë më shumë vota në raundin e parë. Në raundi i dytë zgjidhet kandidati që ka marrë më shumë vota, me kusht që në votim të kenë dalë më shumë se 40% e votuesve.<sup>61</sup>

Kur bëhet fjalë për rolin e funksionit President i Republikës së Maqedonisë, duhet theksuar se roli i tij në dialogun politik ka aspektet e veta formale dhe joformale që rrjedhin nga specifikat e funksionit që Presidenti i RM-së e kryen. Sa për aspektet formale, dy mekanizma janë jashtëzakonisht të rëndësishme për cilësinë dhe nivelin e dialogut politik në vend:

- Presidenti i Republikës së Maqedonisë ka të drejtë të vetos supenzive. Kjo do të thotë se ligjet I miraton Kuvendi I RM-së, por Kuvendi nuk i shpall. Kjo e bën Presidentin e Republikës së Maqedonisë me dekret.<sup>62</sup> Megjithatë, në situata të caktuara, Presidenti i Republikës mund të vendosë që të mos nënshkruajë ndonjë dekret lidhur me ndonjë ligj të caktuar, pasi së cilës “Kuvendi rishqyrton ligjin në fazë të tretë të leximit, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të ligjit”.<sup>63</sup> Nëse Kuvendi përsëri miraton ligjin e caktuar, Presidenti i Republikës së Maqedonisë është i obliguar të nënshkruajë dekretin për shpalljen e ligjit. Edhe pse kjo e drejtë e Presidentit të Republikës së Maqedonisë nuk është absolute, fakti që Presidenti nuk ka nënshkruar asnjë dekret për ndonjë ligj të caktuar mund të parqet probleme të caktuara në përmbajtjen e legjislacionit, por edhe për shkëlqen e procedurës. Kjo mund të jetë rast që gjatë procedurës së përsëritur, në Kuvend të hapet debat më i fortë politik ose mund të jetë një sinjal që partitë e ndryshme politike ti afrojnë qëndrimet e tyre mbi çështjet e caktuara dhe në mënyrë adekuate të ndryshojn apo plotësojn

59 Neni 79 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë.

60 Ibid, neni 80.

61 Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Maqedonisë është e rregulluar me nenet 80 dhe 81 të Kushtetutës dhe me amendamentin XXXI të Kushtetutës të RM-së

62 Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (tekst i konsoliduar). Neni 173, став 1.

63 Ibid, paragrafi 2.

legjislacioni problematik. Sigurisht, kjo ka ndikim në publikun e gjerë të cilit, përmes së drejtës për të vënë veto mund ti kushtohet vëmendje ndonjë problemi shoqëror, dhe sidomos ndaj ndjeshmërisë së zgjidhjes së këtij problemi.

- Kur bëhet fjalë për deliberimin public dhe dialogun politik, veçanërisht në ltrupin ligjvënës, Presidenti i Republikës së Maqedonisë ka një tjetër kompetencë shumë të rëndësishme. Presidenti i Republikës së Maqedonisë mund të kërkoj nga Presidenti i Kuvendit të thirr seancë Parlamentare<sup>64</sup> nëse konsideron se është e nevojshme një. Gjithashtu, Presidenti i RM-së ka të drejtë të marrë pjesë në punën e Kuvendit të RM-së, e cila gjithashtu zgjeron kapacitetin e këtij funksioni të kontribuon në dialogun politik. Në anën tjetër mundësia e inicimit të seancave në Kuvend i lejon Presidentit të RM-së për të hapur dialog politik brenda legjislaturës rreth çështjeve kritike apo çështje që janë me rëndësi të madhe për publikun, si dhe çështjet e natyrës urgjente.

Përveç rolit formal në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë, presidenti i vendit ka një rol simbolik joformal por të rëndësishëm në dialogun politik. Në fakt historia politike e Maqedonisë na tregon se Presidenti mund të inicioj proces të dialogut politik për çështje të diskutueshme (takimet të liderëve), por mund të jenë edhe nisma të veçanta, të cilat edhe pse nuk janë zyrtarisht pjesë e kompetencave të tij, mund të kontribuojnë në zgjidhjen e probleme të caktuara në dialogun politik, veçanërisht në rrethana kur institucioni që ka rol parësor (Kuvendi i Republikës së Maqedonisë) është i paaftë (këtu mendohet për Komisionin që u krijua për të sqaruar ngjarjet e 24 dhjetorit të vitit 2012).

## **HAPËSIRA JOFORMALE PËR DIALOG POLITIK**

Hapësirë joformale për dialog politik është hapësira politike që zhvillohet jashtë institucioneve të sistemit politik të shtetit. Kjo nuk do të

---

64 Ibid, neni 67, paragrafi 2.



thotë se pjesëmarrësit e saj janë më pak të rëndësishme se institucionet formale, as nuk do të thotë se ata nuk kanë formën e tyre të organizimit përmas të cilit shprehin pikëpamjet e tyre. Në këtë hapësirë do të marrin pjesë organizatat e shoqërisë civile, mediat, bashkësitë fetare, në mbledhjet e komunitetit ndërkombëtar dhe takimet e liderëve.

Këto takime paraqesin forum ku liderët politikë takohen dhe në varësi të kontekstit politik dhe shkallës së ashpërsisë së krizës mund të jetë vend për lloje të ndryshme të dialogut. Në këtë kuptim, takimet e liderëve mund të organizohen për ndërtimin e besimit, por edhe për të rënë dakord rreth çështjeve që krijojnë polemika. Ato mund të jenë të përkohshme ose i përhershme.

Takimet e liderëve në Republikën e Maqedonisë, si vend për dialog politik, kryesisht janë të përkohshme dhe kanë të bëjnë më kriza politike të rëndësishme ose polemika. Për këtë arsye, ata janë shpesh rezultat i ndërmjetësimit përmes angazhimit të komunitetit ndërkombëtar për dialog politik si kusht për integrimin evropian dhe atlantik të vendit. Takimet e liderëve janë hapësirë për dialog të përhershëm politik nëpërmjet të cilit udhëheqësit e partisë do të bien dakord për proces afat-gjatë të reformave.

## Shoqëria Civile

Shoqëria civile në kuptimin më të gjerë përfaqëson hapësirën politike midis shtetit dhe qytetarëve.<sup>65</sup>

Kjo sugjeron se organizatat e shoqërisë civile nuk janë pjesë e aparatit shtetëror, dhe për këtë arsye i përkasin hapësirës joformale të dialogut politik. Megjithatë kjo nuk do të thotë se shoqëria civile është aktor më pak i rëndësishëm në dialogun politik, duke pasur parasysh se ajo është vend ku qytetarët të vijnë së bashku, të organizuar në grupe autonome nëpërmjet të cilave ata paraqesin kërkesa të caktuara politike drejt institucioneve dhe aktorëve politikë. Rëndësia e organizatave të shoqërisë civile në dialogun

65 Linc, Huan & Stepan, Alfred. Demokratska tranzicija i konsolidacija. Beograd: Filip Visnjic, 1998. str.21.

politik vjen nga tri funksionet kryesore që shoqëria civile ka në kuadrin më të gjerë shoqëror:<sup>66</sup>

- Funkzioni i parë ka të bëjë me dimensionin asociativ të shoqërisë civile. Krijimi i shoqatave, bashksive, sindikatat ose çfarë do forme organizative tregon se shoqëria civile është djepi i formave të organizuara përmes të cilave qytetarët mund të vijnë së bashku për arsye të ndryshme. Disa shoqata krijohen për mbrojtjen e ndonjë interesi të veçantë, disa përfshijnë njerëz të ndryshëm me bindjet apo angazhime të ngjashme, ndërsa i treti mund të jetë krijuar ad hoc ose për një kohë të shkurtë, për të adresuar ndonjë problem të caktuar shoqëror. Shoqatat mund të kenë karakter formal (OJQ-të e regjistruara, sindikatat, organizatat fetare) ose karakter joformal (iniciativa, grupe protestuese, tubime etj). Pavarësisht nga forma dhe struktura në të cilën ekzistojnë këto shoqata, organizimi i grupeve të shoqërisë civile paraqet bazë për të marrë pjesë në dialogun politik në vend dhe për të marrë pjesë në deliberimin publik në rast se kemi çështje shoqërore me rëndësi jetike. Kjo ndonjëherë do të thotë se organizatat e shoqërisë civile mund të organizohen kundër shtetit, veçanërisht kur bëhet fjala për çështje shoqërore të polarizuara, presione nga ana shtetit apo çështje të ndjeshme politike, për të cilën nuk ka konsensus të qartë shoqëror.

- Funkzioni i dytë i shoqërisë civile i referohet krijimit të vlerave në fushën e shoqërisë civile.<sup>67</sup> Organizatat e shoqërisë civile janë formuar në bazë të vlerave të caktuara që njerëzit ndajnë me njëri-tjetrin. Shpesh harrohet se këto vlera mund të ketë orientim të ndryshëm ideologjik dhe të jenë kundërthënëse aq sa edhe tek aktorët politikë. Shembuj janë grupe që janë kundër ose pro abortit, apo kundër ose pro edukimit fetarë në shkolla, ose kundër ose pro ekonomisë së lirë etj. Megjithatë, gjenerimi i vlerave të pranueshme për të gjithë në kuadër të dialogut politik në një shoqëri, fillon nga shoqëria civile, në mënyrë ideale duke folur, përmes sferës publike duhet të promovon çka është e pranueshme për një shoqëri dhe çfarë nuk është, çfarë pritet prej aktorëve politikë, çfarë drejtimi duhet të marrë një elitë politike për një çështje të caktuar etj. Megjithatë nuk

---

66 Edwards, Michael. Civil society. Cambridge: Polity Press, 2004. crp.18-36.

67 Ibid.

duhet të harrojmë se në këtë proces ka shpesh mosmarrëveshje në mesin e vetë aktorëve të shoqërisë civile që shpesh çon në konflikt. Prandaj, shoqëria civile ka funksionin e saj të tretë.

- Funkzioni i tretë i shoqërisë civile ka më shumë pika të përbashkëta me dialogun politik. Edhe pse gjenerimi e vlerave shiqërore dhe e dimensionit asociativ janë po aq të rëndësishme, dialogu politik mund të zhvillohet dhe jashtë institucioneve të shtetit për shkak të faktit se shoqëria civile shërben si një zonë publike për shkëmbimin e argumenteve politike. Në sferën publike mund të marrin pjesë të gjithë, nën kushte të barabarta, ndërsa liria e fjalës është e garantuar në të gjitha shoqëritë demokratike. Apo siç thotë Graham Gill sfera publike nënkupton se “ekziston diskutim publik rreth çështjeve shoqërore, me debat të gjerë mbi çështjet në fushën e politikave publike brenda bashkësis, në kundërshtim vendim-marrjen ekskluzivisht nga elitat politike.”<sup>68</sup> Kjo do të thotë se sfera publike është ajo e cila duhet të ndikojë në sjelljen e elitave politike, përmes debatit publik mbi çështjet e rëndësishme shoqërore, e cila nga ana tjetër sugjeron se elitat politike duhet gjithmonë të kenë parasysh qëndrimin e organizatave të shoqëris civile mbi çështje të caktuara gjatë vendimmarrjes në fushën e politikave publike.

## Media

Hapësira joformale politik për dialog politik nuk shteret vetëm me funksionimin e organizatave të shoqërisë civile, në fakt, është shumë e vështirë të përcaktohet se ku janë kufijtë e shoqërisë civile, por edhe ku është kufiri midis formalitetit dhe joformalitetit, kur bëhet fjalë për aktorët në dialogun politik. Ndoshta më të vështira për tu klasifikuar janë pikërisht mediat duke pas parasysh faktin se ato i përkasin shoqërisë civile, sferës ekonomike (ata janë subjekte që gjenerojnë fitim), dhe në shumë raste i përkasin sferës politike (për shembull TV shtetërore). Kështu, klasifikimi i tyre si aktorë joformale nuk është mjaft i saktë, edhe pse ekzistenca e tyre nuk është e paraparë në hartimin kushtetues jo vetëm në RM, por në shumicën e shteteve. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se ekzistenca dhe puna e tyre rregullohen me ligje të cilat janë subjekt i ndryshimit, dhe jo me Kushtetutën e RM-së si document më afat-gjatë dhe më stabil me të cilin skicohet dizajni kushtetues i shtetit, ato janë të vendosura në këtë pjesë të manualit.

Vet funksioni i medias në komunikimin politik është i qartë. Ata janë instrumenti kryesor përmes të cilit mesazhet politike transmetohen në sferën publike, por edhe përmes të cilit qëndrimet e kundërta të opsioneve të ndryshme politike, në varësi të politikës editoriale të ndonjë medium të caktuar. Në kuadër të dialogut politik, është e qartë se media krijojnë klimën në të cilën debatohet mbi çështje të caktuara, me këtë edhe marrëdhëniet në mes vetë aktorëve (formal dhe joformal), por kanë edhe tre funksione të tjera<sup>69</sup>:

- Mediat si mjet për zgjedhjen e lajmeve (gatekeepers) – ky funksion i medias ka të bëjë me përzgjedhjen e lajmeve dhe përmbajtjes që bëhen apo nuk bëhen të disponueshme për publikun. Kjo do të thotë se politika editoriale e mediave është bazë sipas të cilës zgjidhet se çka do

---

69 [https://cdn.icivics.org/sites/default/files/uploads/Role%20of%20Media\\_0.pdf](https://cdn.icivics.org/sites/default/files/uploads/Role%20of%20Media_0.pdf)

të prezantohet (dhe nga cili kënd) dhe çka do ti ofrohet publikut. Politika editoriale në anën tjetër varet nga struktura ekonomike e medias por edhe nga orientimi politik i të njëjtit.

- Mediat si “agjendë hartues”. Ky funksion i mediave është i lidhur ngushtë me funksionin e tyre në sferën publike. Kjo do të thotë se mediat janë ato që krijojnë prioritete rreth asaj se çfarë është e rëndësishme dhe çfarë nuk është e rëndësishme në diskursin publik, dmth ata e caktojnë agjendën e temave rreth të cilave diskutohet në një shoqëri. Edhe pse zgjedhja e temave që diskutohen në sferën publike mund të duket logjike, është e qartë se mediat kanë

- fuqi për të fshehur tema të caktuara apo për të zvogëluar rëndësinë e tyre, në varësi të politikës editoriale dhe interesit të ndonjë medium të caktuar.

- Mediat si “mbikëqyrëse”. Ky funksion i mediave gjithashtu ka rëndësi të madhe në dialogun politik, duke pas parasysh faktin që mediat janë shpesh ata që me zë të lartë lajmërojnë për fenomene të caktuara shoqërore e politike, sidomos kur ato shkaktojnë polemika ose nuk janë brenda rregullave shoqërore. Ky funksion paralajmërues i medias është shumë i rëndësishëm në demokracitë moderne, duke pasur parasysh faktin se mediat kanë rol që vazhdimisht të mbajnë pushtetin nën kontrollin demokratik dhe publikisht të kritikojnë kur ka bazë për ta bërë.

Lidhur me vlerësimin e mjedisit mediatike në Republikën e Maqedonisë, si bazë për një dialog të mirë politik, ka disa organizata që merren me vlerësimin e mjedisit mediatik. Pra, IREX (International Research and Exchange Board) sistemin mediatik maqedonas e vlerëson midis “system i përzier i paqëndrueshëm i mediave” në tranzicion tek “gati i paqëndrueshëm”, në periudhën midis vitit 2002 dhe vitit 2008<sup>70</sup>. Me vlerësimin e tillë bie dakord edhe Freedom House ku Republika e Maqedonisë merr nota relativisht të paknaqëshme në bazë të sistemit mediatik me vërejtje të shumta mbi punën e tyre<sup>71</sup>. Kjo sigurisht tregon se sistemi mediatik maqedonase ka vend për

70 International Research and Exchange Board (IREX). Media sustainability index Europe and Eurasia – compilation of annual scores 2001-2010. Në dispozicion në <http://goo.gl/Yacd9x> (qasur më 29.08.2014).

71 Nations in transit – country report Macedonia 2009. Freedom House. Сrp. 347. Në dispozicion në

përmirësim, që nënkupton përmirësimin e potencialit për dialog politik në vend.

Kur bëhet fjalë për hapësirën për dialog politik në media nuk mund të shmanget tema e mediave të reja ose të ashtuquajturat rrjete sociale të cilat zënë më shumë hapësirë në dialogun politik të shoqërive bashkëkohore. Pra, rrjetet sociale janë gjithnjë e më shumë duke u bërë një hapësirë në të cilën zhvillohet dialogu politik, ndërsa gjithashtu është duke u ndryshuar edhe pamja e sferës publike si dhe demokracisë si sistem<sup>72</sup>. Disponueshmëria e tyre, shpejtësia e shpërndarjes së informacionit, por edhe paaftësia të censurohen shpejt dhe me efikasitet, bën sferën e lirisë dhe hapësirës politike në të cilën dialogu politik gjithnjë e më shumë zhvillohet dhe në të cilën në të njëjtën kohë marrin pjesë de aktorë formal dhe joformal.

## **Bashkësitë fetare**

Aktorët jo më pak të rëndësishme në hapësirën joformale të dialogut politik dhe janë edhe bashkësitë religjioze, në fakt fetare. Ato janë veçanërisht të rëndësishme në pjesën në të cilën dialogu politik zhvillohet për çështje morale, çka në të vërtetë mbulon një hapësirë të madhe politike e cila i referohet parimeve, zgjidhjeve të problemeve të caktuara shoqërore por edhe legjislacion specifik. Në këtë kuptim, në të gjitha sistemet plurale, në të cilat liria e besimit fetar është e garantuar, bashkësitë fetare intensivisht marrin pjesë në mënyrë aktive në sferën publike, por edhe në dialogun politik për çështje të interesit të tyre.

Në Maqedoni, analizat tregojnë se bashkësitë fetare gëzojnë besim të madh në mesin e qytetarëve<sup>73</sup>, që i bën ata faktor relevant në dialogun politik në vend. Besimi i lartë që gëzojnë nga qytetarët hap mundësinë për të marrë

---

<http://goo.gl/2kMJvU> (qasur më 29.08.2014).

72 Shih shembullin në Axford, Berrie & Huggins, Richard (eds.). *New Media and Politics*. London, Thousand Oaks, New Delhi: Sage publications, 2001.

73 Shih shembull Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP). Raporti i paralojmërimit të në kohë. Shkup: UNDP, 2005. f.61. dhe P13.

pjesë në mënyrë aktive në diskutimet për çështjet e ndjeshme shoqërore, dhe me qëndrimin e tyre të kontribuojn në dialogun politik në një raport me numër çështjesh në interes, jo vetëm të aktorëve politikë, por edhe për publikun e gjerë.

## **Bashkësia ndërkombëtare**

Edhe pse bashkësia ndërkombëtare nuk është një faktor formal, në aspektin e aktorit që ka vendin e stit në dizajnin kushtetues të institucioneve politike në Republikën e Maqedonisë, ajo mbetet ndoshta aktori më me ndikim në dialogun politik në vend. Ashtu si kronologjia e krizave politike në vend dhe studimet e rasteve që janë ilustruar në këtë manual, bashkësia ndërkombëtare e mishëruar kryesisht me BE-në dhe SHBA-në kanë një rol të rëndësishëm në tejkalimin e krizës në dialogun politik në RM. Në këtë drejtim, bashkësia ndërkombëtare shpesh duket si lehtësues në krizën e dialogut politik (kriza e vitit 2001), si iniciator i zgjidhjeve (krizan e 24 dhjetorit të vitit 2012), ose si aktor i veçantë që ka bërë presion të fortë politik për zgjidhjen e krizve që krijohen midis aktorëve politikë (Marrëveshje e Majit v.2007.)

## **Studimi i rastit “Wilton Park”**

Në fund të vitit 2007, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ndodhi bllokadë e punës me zgjatjen e saj përmes debatit rreth amendamenteve e iniciuar nga LSDM dhe BDI. Tensioni arriti kulmin me një incident mes BDI-së dhe PDSH-së, e cila la hapësirë që diplomatët e huaj të inicojn ndërmjetësim midis aktorëve politikë.

Nën kujdesin e Zyrës së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, dhe me mbështetje nga aktorë të ndryshëm vendas dhe të huaj, një grup prej

26 deputetëve udhëtuan për në Wilton Park pranë Londrës.<sup>74</sup> Qëllimi i këtij konfrontimi ishte që me ndihmën e ndërmjetësimit, deputetë nga grupe të ndryshme parlamentare të punojn për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional e cila do të mundëson punë më të mirë të trupit ligjvënës.<sup>75</sup>

Më konkretisht, ideja prapa “Wilton Park” ishte deputetët përmes punës në grupe, të përgatitin plane të veprimit përmes të cilive përmirësimet në funksionimin e Kuvendit do të jenë të matshme. Në të njëjtën kohë, çështja politike në lidhje me përdorimin e gjuhës shqipe u vu gjithashtu në rendin e ditës, por në një formë më pak të strukturuar.<sup>76</sup>

Ishin të formuara tri grupe punuese. Tema qendrore e grupit të parë të punës ishte miratimi i Ligjit për Kuvendin dhe aktivitetet rreth përgatitjes së, si përfshirjen e ekspertëve dhe analizë krahasuese të legjislacionit, por edhe përfaqësim në kuadër të partive të tyre dhe mediave të tyre.<sup>77</sup>

Tema kryesore e grupit të dytë ishte ndërtimin i kapaciteteve të Kuvendit. Pjesa e parë ishte në lidhje me iniciativën për themelimin (e çfarë më vonë do të bëhej) Instituti parlamentar, si mbështetje këshillimore për deputetët. Pjesa e dytë ishte rreth e-Kuvendit dhe elektronizim të punës së tij. Pjesa e tretë ka të bëjë me transformimin e Kanalit televiziv kuvendor.<sup>78</sup>

Grupi i tretë punues mbante dy tema kryesore. E para kishte të bënte me planifikim më të mirë të aktiviteteve parlamentare përmes nismave për koordinim më të mirë mes grupeve parlamentare dhe marrëdhëniet me qytetarët përmes caktimit të një dite dedikuar për votuesit. Tema e dytë kryesore e këtij grupi pune ishte për të mundësuar pavarësinë financiare të Parlamentit, sidomos duke krijuar një këshill financiar me të cilin deputetët të koordinuar do të vepronin në lidhje me buxhetin e propozuar për institucionin.<sup>79</sup>

Për të tre grupet punuese ishin vendosur koordinatorë, ndërsa

---

74 Intervistë me E.A.

75 Fondacioni Westminster për Demokraci: Raporti “Wilton Park”

76 Ibid

77 Programi i “Wilton Park”

78 Ibid

79 Ibid



për një pjesë nga pikat e programit ishin caktuar afate. Në këtë mënyrë, suksemi i procesit të dialogut politik mund të matej më mire, ndërsa ishte i vendosur edhe mekanizëm i “pronësisë” përmes të cilit deputetët (sidomos koordinatorët) u vënë në pozicioni të përfaqësojnë ndryshimet e propozuara.

Ajo që mund të vërehet nga programi i propozuar është se ajo kishte anashkaluar problemet qendrore si mungesa e dialogut politik apo bojkotimi i asaj periudhës. Përkundrazi, fokusi ishte më shumë në kuadrin teknik dhe ligjor për forcimin e procedurave dhe kapaciteteve të institucionit. Edhe pse kjo në shikim të parë mund të interpretohet si vendosje qëllimë të arritshme, është e nevojshme të mirret parasysh konteksti i plotë.

“Wilton Park” si platformë ishte një proces afat-shkurtër prej më pak se një javë, prandaj nuk mund të pritet zgjidhja e problemeve të vjetra afat-gjate si mosbesimi mes aktorëve politikë. Në të njëjtën kohë, edhe pse u diskutuar për çështje më të gjera, çështje e polemike si përdorimi i gjuhës shqipe për udhëheqjen e senacave parlamentare (gjë që është ndryshe nga përdorimi i gjuhës në fjalimet individuale) është vetëm diskutim paralel, e ndarë nga aktivitetet për zhvillimin e planeve të veprimit. Arsyeja për këtë ndarje ishte për tu siguruar se bisedimet e dështuara mbi një çështje polemike nuk do ta rrezikonte punën praktike mbi qëllimet kryesore të takimit.<sup>80</sup>

Duke folur në përgjithësi, ndryshimet e planifikuara formale dhe teknike në “Wilton Park” me afate të caktuara dhe transferim i “pronësisë” dhe motivi për përfaqësim në periudhën pas takimit ishin të realizuara.<sup>81</sup> Kjo “pronësi” e problemit dhe zgjidhja u la në duart e deputetëve, në bashkëpunim me faktorë të ndryshëm të jashtëm dhe të brendshëm të diplomacisë dhe të shoqërisë civile të cilët luajnë rolin e mbështetjes teknike dhe financiare të reformave. Përveç kësaj, gjatë procesit të negociimit, deputetët u koordinuan me elitat e partisë në shtëpi, me çka siguruan përfaqësim më afatgjatë të procesit reformues edhe nga selitë e partive.

Megjithatë, vetë “Wilton Park” nuk arriti të sigurojë ndryshime afatgjate. Pas një kohe, Rregullorja e Kuvendit, si dokument i planifikuar “midis rreshtave” të agjendës së u miratua pa praninë e opozitës në mes të

80 Fondacioni Westminster për Demokraci: Raporti “Wilton Park”

81 Intervistë E.A.

vitit 2008. Përveç kësaj, “Wilton Park” nuk arriti ti “parandalon” incidentet e 24 dhjetorit të vitit 2012 dhe bojkotin e mëvonshëm të Kuvendit, pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2014.

Një shpjegim për dështimin është ajo se nuk ishte i shoqëruar me përpjekje të rëndësishme për të krijuar platformë më afat-gjate për dialog midis aktorëve politikë përmes të cilis gradualisht do të trajtohet konflikti themelore dhe mosbesimi ndërmjet partive dhe individëve në të. Qëndron përshtypja se forumet që dalin nga planifikimi I “Wilton Park” e organizuar nga shoqëria civile, dhe ku aktorët politikë të takohen, është i motivuar nga kushtet për integrimin evropian dhe standardet për matjen e suksesit. Ky mekanizëm i kushtëzimit, edhe pse është i shpesht në procesin e dialogut politik dhe ndërmjetësimit, duhet të mbështetet me “brendësim” të konsiderueshëm të synimeve tek aktorët politikë, që negociojn.

## **KRIZA PARLAMENTARE E 24 DHJETORIT 2012**

Sfida më e madhe për demokracinë parlamentare maqedonase ndodhi më 24 dhjetor, 2012.<sup>82</sup> Ngjarjet që kanë ndodhur në Kuvend dhe jashtë tij çuan në një nga krizat më të këqija në dialogun politik në vend, dhe kishte implikime më të gjera për reputacionin e shtetit. Miratimi i buxhetit të Republikës së Maqedonisë në vitin 2013 u shndërrua në një luftë mes deputetëve dhe sigurimit të Kuvendit, dhe në tërë situatën u përfshin edhe mediat të cilat u dëbuan nga salla parlamentare.

Fillimi i krizës që ndodhi më 24 dhjetor v.2012 duhet të kërkohet në procesin e miratimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2013. Debati mbi buxhetin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2013 u zhvillua në lidhje me strukturën e buxhetit, dmth deputetët e opozitës pretenduan se buxheti është tej-ekstenziv, që shpenzimet që janë të pozicionuara në buxhet

82 Analiza e krizës parlamentare, paraqet version të shkurtuar dhe përshtatur versionit të tekstit Markovic, Nenad & Presova, Denis. „Izazovi parlamentarne demokracije u Makedoniji“. vo Političke analizebr.14/ lipanj 2013. Fakultet političkih znanosti Zagreb, 2013.

janë shumë të mëdha përkatësisht se buxheti i strukturuar në këtë mënyrë nuk e stimulon zhvillimin ekonomik. Opozita gjithashtu kundërshtoi se një pjesë e madhe e shpenzimeve janë për pozicione joproductive. Beteja politike zhvillohej në kuadër të Komisionit për Financim dhe Buxhet, ku deputetët e opozitës propozuan më shumë se 1200 amendamentet për buxhetin e vitit 2013 me arsyetimin se këto ndryshime do të ndihmojnë Republikën e Maqedonisë të kursen mbi 200 milion euro në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Implikimi praktik i kësaj do të ishte Buxheti të mos miratohej deri në fund të vitit aktual (siç përcaktohet nga legjislacioni), sidomos duke pasur parasysh se në Rregulloren e Kuvendite nuk ekziston kufizim i minutazhes së fjalimit të secilit deputet në seancat për amendamentim brenda komisioneve. Në mungesë të Buxhetit, sipas shumicës në pushtet, ishin të kërcënuara pozita të rëndësishme buxhetore si rregullimin i borxhit të jashtëm të Republikës së Maqedonisë, por edhe organizimi i zgjedhjeve të ardhshme lokale në mars të vitit 2013, për të cilat duhej të parashihej pozicionet buxhetore ndërsa Buxheti të miratohej në kohë. Ministri i Financave ofroi një kompromis për problemin me pranimin e 44 amendamenteve të opozitës në kundërvlerë me 3 milion euro të kursyera në Buxhetin e RM-së, gjë që opozita e vlerësoi si të pamjaftueshme dhe vetëm si lëvizje simbolike.

Kjo praktikë e përdorimit të definicioneve të procedurave në parlamentet e mbarë botës për të vonuar miratimin e ndonjë legjislacioni të caktuar ekziston në shumë parlamente, dhe është i njohur si “filibastering”.

Ana tjetër e shkaktimit të krizës qëndron në shkelje të procedurës për miratimin e buxhetit që rrjedhimisht çoi në ngjarje të padëshirueshme në Kuvend dhe jashtë tij. Përshkak të filibasteringut, President i Parlamentit, vendosi të thërrasë një seancë plenare në fazën e leximit të dytë, ndërsa dy komisionet e përkatëse të cilat duhej të paraqisnin raportin e tyre në Kuvendin RM-së ende nuk kishin mabruar me punë. Kjo shkaktoi revolt në mesin e deputetëve të opozitës të cilët gjatë përpjekjes për fillim të seancës plenare, e bllokuan foltoren parlamentare dhe hynë në mosmarrëveshje verbale me Kryetarin e Kuvendit.

Zhvillimi i mëtejshëm i kësaj krize parlamentare eskaloj në ndoshta një prej ngjarjeve më të pakëndëshme në historinë e demokracisë parlamentare maqedonase. Gjegjësisht, në një situatë ku ishte e pamundur për të vazhduar seancën sipas kushteve të ekzistuese, Kryetari i Kuvendit vendosi të thërrasë sigurimin me qëllim që të largon nga oltorja deputetët e opozitës deputetët e opozitës. Skenat e pakëndëshme nga njëra anë të shkaktuara edhe nga vetë deputetët që bënë rrëmujë në sallën parlamentare, por edhe nga ana e sigurimit I cili me forcë I largoi deputetët nga salla parlamentare. Rezultati përfundimtar ishte dëbimin e deputetëve të opozitës nga salla, dëme në inventarin e kuvendit dhe disa deputetë të lënduar të opozitës. Kësaj ngjarjeje ju shtua edhe vendimi për largimin e mediave nga salla parlamentare, vendim i cili shkaktoi reagim të madh në mesin e tyre. Pas këtyre ngjarjeve fatkeqe, seanca e Kuvendit të RM-së vazhdoi me punë, ku dhe u miratua Buxheti për vitin 2013, ndërsa në seancën e njëjtë u zgjodh edhe Avokati i Popullit. Katër ditë më vonë u miratua edhe Ligjin për ekzekutimin e buxhetit.

Ngjarjet e 24 dhjetorit të v.2012 hapën disa dilema. Megjithatë, esenca e debatit publik pas ngjarjeve në Kuvendin e RM-së u ul në disa dimensione, por më së shumti në dëmtimin e procedurës dhe të kuadrit ligjor, i shfrytëzuar për të njëjtin.

Sa për procedurën formale, më shumë se e qartë është se ajo është thyer duke pasur parasysh faktin se dy komisionet përgjegjëse për çështjet buxhetore nuk kishin përfunduar me punën e tyre. Numri i madh i amendamenteve të paraqitura nga opozita për Buxhetin e vunë shumicën në pushtet në një pozitë të vështirë ku zgjedhja ishte miratimi i buxhetin me shkelje të procedurës (e cila edhe u bë), apo të mos mirratohej buxheti në kohë për vitin 2013, i cili do të shkaktonte implikime serioze financiare për shtetin.

Dimensioni i dytë që është i rëndësishëm për këtë krizë është baza ligjor mbi të cilën u bazua Kryetari i Kuvendit gjatë përjashtimit të deputetëve të opozitës nga salla parlamentare. Kryetari i Kuvendit u bazua në nenet e Rregullores së Kuvendit që kanë të bëjnë me ruajtjen e rendit gjatë seancave, dmth në Nenet 91 deri 94 të Rregullores. Këto nene parashikojnë që Kryetari i Kuvendit është përgjegjëse për ruajtjen e rendit në seancë;

që ka të drejtë të paralajmëron ose privon nga e drejta në fjalë deputetin nëse cenon rendin e seancës; që ka të drejtën për të largon deputetin e paralamruar disa herë, përkatësisht në rast se I është marrë e drejta në fjalë, dhe ai vazhdon të pengoj punën gjatë seancës ose përdor shprehje që janë të padenja për dinjitetin e Kuvendit; se deputeti që është i larguar duhet menjëherë të largohet nga salla ku mbahet séance, dhe në qoftë se nuk mund të mbahet seanca, kryetari do të cakton ndërprerje të shkurtër të të njëjtës; dispozitat për ruajtjen e rendit në seancë vlejné për të gjithë pjesmarrësit në seancë. Në varësi të interpretimit të ngushtë apo të gjerë të dispozitave të Rregullores së Kuvendit, mbetet e paqartë nëse Kryetari i Kuvendit të RM-së ka apo nuk ka drejtë të veprojë ashtu si ai veproi më 24 dhjetor të vitit 2012. Kjo paraqet problem në disa aspekte. Mbi të gjitha, në qoftë se largimi i deputetëve është vepër kolektive ose individuale (dhe nëse është e mundur ky akt të jetë kolektiv), duke pasur parasysh se janë të larguar një grup i madh i deputetëve të opozitës. Gjithashtu parashtrohet pyetja nëse është e mundur të larohen deputet nga seanca ku ende askush nuk e ka marrë fjalën (dhe që formalisht ende nuk është e hapur, dhe nuk ka rrjedhë normale), duke pasur parasysh se dispozitat e Rregullores së Kuvendit kanë të bëjnë me situatë kur pengohet një deputet tjetër të flas normalisht. Dhe së fundi, nëse rregullat parashohin ndërprerjen e seancës, e jo largimin e deputetëve të opozitës. Këto dyshime mbesin ende të hapura dhe të varura nga interpretimin më i gjerë ose më i ngushtë i Rregullores së Kuvendit të RM-së.

Rezultati i ngjarjeve të 24 dhjetorit të v.2012 ishte lëshimi I Kuvendit të RM-së nga deputetët e opozitës, dhe kërcënimi se opozita nuk do të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme lokale në qoftë se nuk mbahen zgjedhjet parlamentare paralelisht me ato lokale.

Në mënyrë që të qetësohet kriza që u ngrit si rezultat i ngjarjeve të 24 dhjetorit të v.2012 në Kuvendin e RM-së, propozim më konkret erdhi nga Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Gjorge Ivanov. Gjegjësisht, Ivanov menjëherë pas ngjarjeve të propozoi formimin e një komisioni teknik të pavarur i cili do të kishte mandat për të vërtetuar faktet në lidhje me ngjarjet e përmendura. Plani fillestar ishte që komisioni të përbëhet nga presidenti i komisionit i emëruar personalisht nga Presidenti, ndërsa do të

ishite i zgjedhur me konsensus, ndërsa në përbërjen e komisionit të hynin pesë ekspertë, njëri prej të cilëve do të ishte i emëruar nga Presidenti, njëri nga shumica qeverisëse, dy anëtarë nga opozita dhe një ekspert të huaj, por pa të drejtë vote. Ideja mori një rezonancë të madh publike dhe ishte e përkrahur nga Komisioni Evropian dhe bashkësia më gjerë ndërkombëtare. Megjithatë, pavarësisht mbështetjes së kësaj mënyre për zgjidhjen e krizës, partitë e opozitës menjëherë e refuzuan këtë propozim duke aluduar se formimi i komisionit është vetëm një përpjekje për të vonuar përballjen e qeverisë aktuale me përgjegjësinë e saj për shkak të pezullimit të demokracisë në vend.

Megjithatë, duket se ka pasur mospajtime brenda bllokut të opozitës në lidhje me formimin e Komisionit. Nga njëra anë, udhëheqësit e Partisë Liberale dhe Partisë së re Socialdemokrate e ka mbështetën formimin e Komisionit me disa rezerva, ndërsa LSDM dhe PLD më vonë e pranuan propozimin me kërkesë që të mbahen zgjedhje parlamentare në të njëjtën kohë me zgjedhjet e rregullta lokale në pranverën e vitit 2013.

Megjithatë në fund Komisioni u formua me përbërje pak të ndryshuar. Domethënë, në përbërje të Komisionit hynë dy përfaqësues të opozitës, Renata Trenevskaja - Deskovskaja dhe Ljubomir Frckovski, dy përfaqësues nga radhët e shumicës qeverisëse, Ilija Dimovski dhe Blagorodna Duliç, por qëndroi pyetja se kush do të jetë i nominuari për Presidentin e Komisionit nga ana e Presidentit të RM-së, dhe i njëjti të jetë i pranueshëm nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Në fund të përzgjedhjes, e cila ishte e miratuar me konsensus, ishte Dekani i Fakultetit të Drejtësisë, Profesor. Dr. Borçe Davitkovski i cili kryesonte me Komisionin.

Që nga fillimi Komisioni u përball me sfida të shumta për shkak të pikëpamjeve të kundërta të anëtarëve të saj për atë se çfarë ndodhi pikërisht më 24 dhjetor të v.2012. Edhe pse Komisioni kishte mandati për të përcaktuar faktet dhe të jepë rekomandime adekuate, mendime të kundërta kishte më së shumti rreth formulimit të dokumentit përfundimtar, sidomos rreth pjesës nëse kishte shkelje të Kushtetutës së RM-së nga ngjarjet e 24 dhjetorit të v.2012. Kriza që filloi në Komision çoi që presidenti i Komisionit, Profesor. Davitkovski të jep dorëheqje në korrik të vitit 2013. Pas kësaj puna e komisionit ishte në një rrugë pa krye. Megjithatë, kriza u tejkaluar në gusht

te v.2013, kur të gjithë pjesëmarrësit nënshkruan Raportin e Komisionit, gjithashtu u nënshkrua edhe Marrëveshje për Zbatim të Raportit me 11 rekomandime për Kuvendin e RM-së, e cila më vonë këtu raport e miratoi.

Megjithatë, anëtarët e shumicës në pushtet të cilët ishin anëtarë të Komisionit, veçanërisht Dimovski tha se ata kanë rezerva të forta në rreth kualifikimeve ligjore të parashtruara në Raport dhe se nënshkrimi i tij është më shumë në drejtim të interesave të shtetit, e jo në drejtim të pranimi të plotë të përmbajtjes së saj, sidomos pjesa në të cilën implikoet shkelje e Kushtetutës.

Në këtë mënyrë, Raporti si produkt i dialogut politik nuk u përkthye si “pronë” e aktorëve dhe përfaqësimi i tyre nuk u sigurua. Sigurimi i “pronësisë” mbi rezultatet e dialogut është çelësi për afat-gjatsinë e efekteve të procesit të dialogut. Ngjashëm si dhe me “Wilton Park” mungon “brendësim” i marrëveshjes dhe vizionit rreth asaj se si ai, së bashku me qëllimet afatgjata, marrin pjesë në idenë e dialogut.

## **PËRFUNDIMI**

Dialogu politik ndër-partiak nuk është qëllim në vetvete. Ai duhet të jetë pjesë integrale e procesit politik në vend që do të zhvillohet në shumicën e hapësirave shoqërore, në të cilin, përveq partive politike si aktorët kryesorë, do të përfshihen edhe palë të tjera të preokupura në shoqërinë e gjerë civile.

Duke filluar nga kjo, nga kjo analize vijmë në disa konkluzione. Dialogu politik zakonisht paraqitet si një mjet për zgjidhjen e konflikteve. Palët kundërshtarë janë të vendosur se çështjet e hapura mbi të cilat kundërshtohen do të zgjidhin nëpërmjet dialogut. Ky proces shpesh herë është i gjatë dhe konsolidimi si destinacion vështirë arrihet.

Për këtë arsye, është e nevojshme të tregohet kujdes për hapësirat për dialog ku përfaqësuesit e palëve në konflikt në nivele të ndryshme do ta zvogëlojnë tensionin dhe do të ndërtojnë besim të ndërsjellë. Në

Maqedoni, takimet e liderëve, ku udhëheësit e partive mund të punojnë në ndërtimin e besimit të ndërsjellë. Në Kuvend mund të themelohen forume për bashkëpunim mes deputetëve. Megjithatë, duhet të përmendet dhe hapësira joformale për dialog politik, shpesh në kuadër të shoqërisë civile, ku organizatat joqeveritare dhe fondacione punojnë me përfaqësues të partive, duke ndërtuar besim të ndërsjellë.

Por, dialogu politik ndër-partiak nuk është vetëm një mjet për të dalë nga ndonjë krizë. Ai është mjet kyç për procesin e qëndrueshëm të reformave dhe është nevojshme të investohet në aktivitete afatgjata nëpërmjet të cilave ky dialog do të zhvillohet. Forumet përmes të cilave dialogu midis partive zhvillohej deri më tani janë vetëm të përkohshme. Përtej hapësirës formale për dialog politik këtu janë takimet në parqet “Wilton Park” të Mavrovës dhe shkolla dhe trajnimet e herë pas herëshme të organizuara nga organizatat e qytetarëve.

Përmes një procesi të gjatë të trajnimit të përbashkët, përfaqësuesit e partive politike mund për vete ti ndryshojnë vetitë e kulturës politike që i rrethon, e cila nuk është shumë adekuate për dialogun ndër-partiak.

Të gjitha këto përfundime konvergojnë drejt pikës qendrore të dialogut politik - kapitali njerëzor. Pikëpamja se dialogu dhe bashkëpunimi janë pjesë e pandarë e procesit politik dhe duhet brendësuar në sjelljen politike të aktorëve në të njëjtën mënyrë si ajo ishte bërë për konkurrencë politike. Qëllimi i dialogut nuk është nënshkrimi i dokumentit përfundimtar, por të qëndrohet prapa marrveshjes dhe së bashku të kapërcehet kriza ose të bëhet ndryshim.



## **BIBLIOGRAFIA**

Axford, Berrie & Huggins, Richard (eds.). *New Media and Politics*. London, Thousand Oaks, New Delhi: Sage publications, 2001.

Commission of the European Communities. *The Former Yugoslav*



Republic of Macedonia 2007 Progress Report.Brussels, 6.11.2007.SEC (2007) 1432.достапно на <http://goo.gl/s4Kc6F>

Edwards, Michael. Civil society. Cambridge: Polity Press, 2004.

Gill, Graeme.The dynamics of democratization.New York: St. Martin's Press. 2000.

<https://cdn.icivics.org/sites/default/files/uploads/Role%20of%20Media%200.pdf>.

International Research and Exchange Board (IREX). Media sustainability index Europe and Eurasia – compilation of annual scores 2001-2010. достапно на <http://goo.gl/Yacd9x>

Kemp, B., 2013. Political Party Dialogue: A Facilitator's Guide. International IDEA / NIMD / The Oslo Center.

Linc, Huan & Stepan, Alfred. Demokratska tranzicija I konsolidacija. Beograd: Filip Visnjic, 1998.

Markovic, N., Troshanovski, M., Popovikj, M., Misev, V., 2012. Political culture in Macedonia. Fridrich Ebert Stiftung, Skopje.

Markovic, Nenad & Presova, Denis. "Izazovi parlamentarne demokracije u Makedoniji". во Politicke analizebr.14/lipanj 2013. Fakultet politickih znanosti Zagreb, 2013.

Markovikj, Nenad, Damjanovski, Ivan, Ilievski, Zoran & Bozinovski, Vladimir. „The Role of the European Union in the Democratic Consolidation and Ethnic Conflict Management in the Republic of Macedonia“. Regional Research Promotion Programme, 2011, достапно на <http://goo.gl/DVJiDv>

Nations in transit – country report Macedonia 2009. Freedom House. достапно на <http://goo.gl/2kMJvU>

Rasch, Erik Bjorn. Legislative debates and democratic deliberation in parliamentary systems.Preliminary draft paper for Presentation at the Oslo-Yale International Workshop on Epistemic Democracy in Practice, Yale University, New Haven, 20-22 October, 2011. достапно на <http://goo>.

gl/TbgYhs

Ropers, N., 2004. From Resolution to Transformation: The Role of Dialogue Projects, in: Berghof Handbook for Conflict Transformation. Berghof Foundation, Berlin.

United Nations Development Programme, 2009. Why dialogue matters for conflict prevention and peacebuilding. Достапно на <http://goo.gl/JvoMiG>

Fondacioni Westminster për Demokraci: Raporti “Wilton Park”

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (tekst i konsoliduar). Në dispozicion në <http://goo.gl/qDSvpP>

IDSCS: “Opinionimi publik mbi bojkotin e opozitës, dialogun politik dhe gjendja ndëretnike në Republikën e Maqedonisë” në dispozicion në <http://goo.gl/9OySSR>

Shih shembull Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP). Raporti i paralajmërimit të në kohë. Shkup: UNDP, 2005.

Kushtetuta e Republikë së Maqedonisë. në dispozicion në <http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspX>

Cekov, A., Daskalovski, G., 2013. Analiza e demokracisë së brendshme të partive në Maqedoni. Fondacioni Konrad Adenauer, Shkup.

Shkaric, Svetomir dhe Siljanovska, Gordana. E drejta kushtetuese. Shkup: Kultura, 2009.

## **Misha Popoviç**

Misha Popoviç është magjistër i studimeve për identitet, kulturë dhe pushtet i Shkollës për studime slave dhe evropës lindore në Kolegjin Universitar në Londër. Është i fokusuar në mitologjin politike dhe identitetet kombëtare në Ballkan.

Duke fillar nga viti 2004 ai punon në Institutin për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup.

Kontribon në projektet hulumtuese të organizatës dhe merret me tema të udhëheqjes së mirë , kulturës politike dhe opiniot publik.

## **Dr. Nenad Markoviq**

Dr. Nenad Markoviq është profesor në Fakultetin Juridik "Justinian I". Ka doktoruar mbi temën "Ndikimin e OJQ-ve në tranzicionin demokratik dhe konsolidimin e Republikës së Maqedonisë." Në studimet deri-diplomike Dr. Nenad Markoviq ligjeron lëndët: Teoritë politike, shoqëria civile dhe filozofia politike dhe në master studime ligjeron më shumë lëndë duke përfshirë qeverisje dhe menaxhim i mirë, mitologjia politike, kultura politike, etj ..

Fushat me interes shkencor të Dr. Nenad Markoviq janë teoria politike, historia e mendimit politik, shoqëria civile, nacionalizmi dhe ndërtimin e shtetit, kultura politike, mitologjia politike etj.. Ai është anëtar i bordit redaktues të revistës "Mendimi politik" dhe një nga themeluesit dhe studiuesve aktive në një nga think tank-et më të vjetra në Republikën e Maqedonisë, Institutit për demokraci "Societas Civilis" - Shkup.



## **Fondacioni Konrad Adenauer**

### **Zyra në Maqedoni**

Risto Ravanovski 8  
MK-1000 Shkup

Tel: +389 2 323-1122  
Faks: +389 2 313-5290  
E-mail: Skopje@kas.de

[www.kas.de/macedonia](http://www.kas.de/macedonia)  
[www.idscs.org.mk](http://www.idscs.org.mk)